



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkia Skrapar**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**MBI**  
**“AUDITIMIN FINANCIAR”**

**BASHKIA SKRAPAR**

**Tiranë, shkurt 2026**

## Përmbajtja

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4-7</b>
<b>I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.....</b>	<b>7-8</b>
<b>II. HYRJA.....</b>	<b>8-9</b>
<b>OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.....</b>	<b>9-12</b>
1. Objektivat dhe qëllimi.....	9-9
2. Identifikimi i çështjes.....	9-9
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	10-10
4. Përgjegjësitë e audituesve.....	10-11
5. Kriteret e vlerësimit.....	11-11
6. Standardet e auditimit.....	11-11
7. Metodatat e auditimit.....	11-12
8. Dokumentimi i auditimit.....	12-12
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>13-51</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Skrapar”.....	13-14
2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.....	14-51
<b>IV. REKOMANDIME.....</b>	<b>51-63</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:**

Bashkia Skrapar, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Bashkia Skrapar bën pjesë në Qarkun e Beratit dhe është një nga pesë bashkitë e këtij Qarku. Bashkia Skrapar në gjithë qarkun zë 43% të sipërfaqes së gjithë qarkut. Skrapari kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkinë Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.**

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenit 50 “Auditi i jashtëm”, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”.

Ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Skrapar si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Skrapar për periudhën e aktivitetit 2024 qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

### **c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit.* Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm

për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 9,925 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

**g. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:**

Në raportin e auditimit janë formuluar **19** gjetje dhe **21** rekomandime për masa organizative, **1** gjetje dhe rekomandime mungesë të ardhurash në shumën **2,837** mijë lekë dhe **1** gjetje dhe rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre në vlerën **2,696** mijë lekë.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

- Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit në Bashkinë Skrapar u konstatua që kontabiliteti nuk mbahet në bazë të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara por mbahet në bazë të likuidimeve të kryera të dokumentacioneve të shpenzimeve.

-Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Skrapar si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” ka 6 projekte të cilat lidhen me ujësjellës me vlerë historike 78,985,358 lekë që duhet të transferohen në “*Sh. R. U. K. B. Sha*” me NIPT. M..O. Nuk ka informacion në lidhje me përfundimin e objekteve që u përkasin 13 projekteve në vlerën 14,852,624 lekë. Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” nuk paraqet situatën e saktë dhe të drejtë të saj.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që në llogarinë 210 “*Toka, troje, terrene*” nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të;

a) trojeve nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në Njësi Administrative, etj.

- Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 210 “*Toka, troje terrene*” u konstatua se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024 pasi kontabilizimi dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të.

- Në llogarinë “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, është pasqyruar vetëm “*Pyllëzimi Kurorës së Qytetit të Çorovodës*” në vlerën 6,911,988 lekë. Bashkia në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Skrapar, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*”, e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4. Pra, llogaria 211 “*Pyje Plantacione*”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

- Në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, në një numër të konsiderueshëm objektesh të trashëguar nga ish komunat ka pasaktësi në pasqyrimin në kontabilitet në lidhje me sipërfaqen, gjendjen e tyre, truallin nën objekt dhe sipërfaqet rrethuese. Llogaria nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që Llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” në datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën zero lekë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se Bashkia Skrapar është aksionarë në Shoqërinë e re të krijuar “*Sh. R. U. K. B. Sha*” me NIPT. M..O. Bashkia

Skrapar zotëron 4,7% të aksioneve ose në vlerë kapitali 470,000 lekë (10,000,000\*4,7%).

- Nga auditimi u konstatua që me shkresën nr.480.prot., datë 10.02.2025 dërguar pranë Ministrisë së Financave “*Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësisë Financiare*” janë paraqitur detyrime të prapambetura ndaj të tretëve në vlerën totale 12,732,566 lekë. Në pasqyrat e pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar janë pasqyruar detyrime në vlerën 4,316,066 lekë. Pra janë paraqitur detyrime më pak në vlerën 8,416,500 lekë (12,732,566-4,316,066). Për rrjedhje llogaria 467 “*Kreditore te ndryshëm*” është nënvlerësuar për vlerën prej 8,416,500 lekë (12,732,566 - 4,316,066).

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua Llogaria 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*” është mbivlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë (115,916,958-102,473,734) ndërsa llogaria 470 “*Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë*” është nënvlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë që është shtesa e debitorëve për vitin 2024.

- Nga auditimi i pasqyrës së performances financiare në pasqyrat financiare të konsoliduar u konstatua që Llogaria 73 “*Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve*” në vlerën minus 2,134,106 lekë është paraqitur gabim në pasqyrat financiare të konsoliduar, pasi vlera e kësaj llogarie duhet të ishte paraqitur zero lekë, rrjedhimisht është nënvlerësuar për vlerën 2,134,106 lekë. Ky veprim ka sjellë uljen e rezultatit të veprimtarisë së vitit ushtrimor në vlerën 2,134,106 lekë.

- Nga krahasimi me të dhënat e thesarit rezulton se ka pasaktësi në pasqyrimin e taksave dhe tarifave vendore sipas kodeve përkatëse të të ardhurave. Vlera prej 5,670,966 lekë nuk është paraqitur si zë më vete në llogarinë “*Tatim nga të ardhurat Personale*”.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që në llogarinë 627400 likuidime në vlerën 2,695,558 lekë për shpenzime gjyqësore dhe shpenzime përmbarimore në 8(tetë) urdhër shpenzime duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit dhe shpenzime pa ekonomikitet në vlerën 2,695,558 lekë.

#### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin në pasqyrën e performances financiare të shpenzimeve për vlerën e nënvlerësuar prej 6,314,560 lekë si dhe të marre masa për njohjen e shpenzimeve në pasqyrën e performances financiare sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

- Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për saktësimin e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave në Njësinë Shpenzuese të Ndërmarrjes së Shërbimit Publik për vlerën 1,619,749 lekë, duke ngritur komision të posaçëm të vlerësimit dhe asgjësimit.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me njësinë e varësisë të marrë masa të pasqyrojnë saktë në pasqyrën e pozicionit financiar llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” e cila është mbi vlerësuar në vlerën 6,802,914 lekë dhe llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin të drejta*” e cila është nënvlerësuar po për të njëjtën vlerë.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marre masa të saktësojë llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është nënvlerësuar për vlerën prej 24,115,957 lekë.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin në pasqyrën e performances financiare të llogarisë 73 “*Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve*” për pasqyrimin e saktë dhe të drejte të sajë për vlerën e nën vlerësuar prej 2,134,106 lekë, rrjedhimisht në pakësimin e llogarisë 85 “*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*”.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin në pasqyrën e performances financiare të llogarisë 73 “*Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve*” për pasqyrimin e saktë dhe të drejtë të sajë për vlerën e nën vlerësuar prej 2,134,106

lekë, rrjedhimisht në pakësimin e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor”.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të kontabilizojë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” debitorët e pa pasqyruar nga kontratat e qirasë të fondit pyjor kullësorë në vlerën totale prej 2,837,420 lekë dhe konkretisht, subjekti “O”, në vlerën 35,000 lekë, subjekti “H. V. E” në vlerën prej 138,245 lekë dhe subjekti “M. E.” në vlerën prej 2,664,175 lekë.

- Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të Buxhetit të Bashkisë në vlerën 2,695,558 lekë, shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore mbi pagesat e kryera për vendimet gjyqësore për gjyqe fituesit.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin në pasqyrën e performancës financiare të të ardhurave sipas kodeve përkatëse për pasqyrimin e saktë dhe të drejte të tyre për vlerën e mbi vlerësuar prej 6,330,863 lekë.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje me pasqyrimin e llogarisë 467 “Kreditore të ndryshëm” e cila është nënvlerësuar për vlerën prej 8,416,500 lekë.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje me pasqyrimin e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë” në pasqyrën e pozicionit financiar pjesëmarrjen në Shoqërinë “Sh. R. U. K. B. Sha” me NIPT. M..O. për vlerën prej 470,000 lekë.

- Kryetari i Bashkisë Skrapar të ngrëjë një grup pune me specialitë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë për llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, mbi gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë llogarinë 230-231 “Investime” në pasqyrën e pozicionit financiar për objektet që janë në proces dhe nuk kanë përfunduar dhe marrë në dorëzim.

## I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

### OPINIONI I AUDITIMIT

#### **Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar për periudhën ushtrimore 2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në pasqyrat financiare të konsoliduar të subjektit Bashkia Skrapar janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**<sup>1</sup>, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

<sup>1</sup> -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet

### **Baza për opinionin e kualifikuar:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705- ISSAI 1705).

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 9,925 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një Opinioni të kualifikuar të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

- Shpenzimet në pasqyrën e performancës financiare nuk janë njohur sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
- Llogaritë e klasës 2 nuk janë pasqyruar saktë dhe nuk janë dokumentuar aktivet sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë;
- Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” nuk është regjistruar saktë pasi është nënvlerësuar për vlerën prej 32,839,035 lekë;
- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk është regjistruar saktë pasi është nënvlerësuar për vlerën prej 8,416,500 lekë;
- Llogaria 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” nuk është pasqyruar saktë pasi është nënvlerësuar për vlerën prej 2,134,106 lekë;
- Asetet nuk janë plotësuar me dokumentacion pronësor, si dhe nuk janë bërë reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj;
- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë” nuk është pasqyruar saktë, pasi nuk ka të kontabilizuar vlerën 470,000 lekë të pjesëmarrjes në “Sh. R. U. K. B. Sha” me NIPT. M.O”;
- Debitorët të cilët vijnë nga kontratat e qirasë të fondit pyjor kullësor, në vlerën 2,837,420 lekë, nuk janë kontabilizuar;
- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në krahasim me thesarin është mbivlerësuar në vlerën 6,802,914 lekë dhe llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është nënvlerësuar për vlerën 6,802,914 lekë;
- Llogaritë 210, 211, 212 nuk paraqesin gjendjen reale pasi nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit vlera e trojeve nën objekt, truallit të godinave të regjistruar në ASHK dhe trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 972/1 prot., datë 13.10.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 13.10.2025 deri më datën 13.11.2025, në subjektin Bashkia Skrapar për periudhën 01.01.2024 deri më datën 31.12.2024 u krye auditimi “Mbi auditim financiar” nga grupi i auditimit me

---

kur: audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.”

përbërje:

1. L. Z., Përgjegjës Grupi;
2. L. Gj., anëtar;
3. E. S., anëtar.

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.**

### **1. Objektivat dhe qëllimi.**

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është, që rezultati, ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Skrapar.

### **2. Identifikimi i çështjes.**

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Skrapar, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Skrapar.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Kryetari i Bashkisë Skrapar (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues

(NA) dhe Drejtori i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Skrapar, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësive së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve. Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

#### **4. Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Skrapar në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arrijtjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe Alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Skrapar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44- 51.

## 5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njëjësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

## 6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

## 7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit.* Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar.
  - *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
  - *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
  - *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërave ose të çdo regjistrimi tjetër.
  - *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
  - *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
  - *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
  - *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **8. Dokumentimi i auditimit.**

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme.

Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u përgatit ky Raport Auditimi Përfundimtar. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Skrapar”

**Zona Gjeografike:** Skrapari kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Skrapar dhe Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.

**Popullsia:** Sipas Çensusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 12,403 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 19,072 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 831.44 km<sup>2</sup>. Sipas çensusit, densiteti i popullsisë është 15 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 22.93 banorë/km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e re e Skraparit ka një relief të thyer malor, i cili ka një territor shumë të gjerë dhe popullsi të ulët. Popullsia e zonës është pakësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit nga largimet e banorëve drejt qyteteve të mëdha të Shqipërisë apo në emigrim. Vetë qyteti i Çorovodës humbi mbi 40 për qind të popullsisë mes viteve 2001 dhe 2011, ndërsa shumë nga komunat përbërëse kanë humbur mbi gjysmën e popullsisë.

Mungesa e perspektivës, kryesisht ajo e vendeve të punës, ka bërë që banorët e qytetit të vendosen për një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre drejt qyteteve të mëdha, ndërsa banorët e zonave të thella janë larguar drejt qytetit të Çorovodës, si rezultat i mungesës së rrugëve dhe mjekëve në fshatrat e tyre. Problematika kryesore e banorëve të Çorovodës ka qenë gjendja e vështirë e rrugës kombëtare Skrapar-Skrapar.

Skrapari si burim kryesor ka të ardhurat që vijnë nga blegtoaria dhe bujqësia, prodhime mjaft të vlerësuara këto në tregjet e vendit, ndër më të njohurat djathi dhe rakia e Skraparit. Vitet e fundit Skraparit i është shtuar shpresa për zhvillimin nëpërmjet turizmit. Kanionet e Skraparit, po tërheqin çdo ditë e më shumë vëmendjen e vizitorëve të huaj dhe vendas.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Skrapar, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Skrapar për periudhën e aktivitetit të vitit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e

kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

## **2. Auditimi mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

1.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

1.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

1.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Në zbatim të Pikës nr. 1, të Programit të Auditimit 972/1.prot., datë 13.10.2025, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.

-Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.

-Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve.

-Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.

-Dokumentacioni i mbajtur mbi realizimin e procesit të inventarizimit.

-Dokumentacioni i mbajtur për administrimin dhe regjistrimin e aseteve me certifikate pronësie.

-Të dhënat e thesarit për llogaritë kontabël të aktivitetit, pasivitetit, detyrimeve dhe llogaritë të ardhurave.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;

Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Udhëzim nr.13, datë 18.12.2024 “Për Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024”.

Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.

Udhëzimi nr.35, datë 29.12.2023 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësite e vetëqeverisjes vendore”.

Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisive të vetëqeverisjes vendore”.

Udhëzim plotësues nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024”.

### **Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2024:**

Për vitin 2024, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.

Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).

Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Pasqyrat statistikore:

Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.

Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

*Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:*

Pasqyrat financiare të konsoliduar dhe Pasqyrat financiare të Njesisë Shpenzuese Bashkia Skrapar (qendra) janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë z. A. M. (Nëpunësi Autorizues) si dhe hartuesi i llogarive z. N. G. (Nëpunësi zbatues). Pasqyrat financiare të konsoliduar përbëhen nga PF të Bashkisë Skrapar si dhe të njësive shpenzuese në varësi, konkretisht:

Pasqyrat financiare të Njesisë Shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë (Nëpunësi Autorizues) si dhe hartuesi i llogarive z. N. G. dhe zj. I. O. (Nëpunësi zbatues).

Pasqyrat financiare të Njesisë Shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, Bashkia Skrapar janë të firmosura nga Drejtori i Drejtori i Njesisë Shpenzuese si dhe hartuesi i llogarive z. E. S.

Të dhëna të detajuara në lidhje me përgatitjen dhe depozitimin e pasqyrave financiare në Degën e Thesarit Skrapar paraqiten në aneksin 1/1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, arkën, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj., të cilat mbahen dhe përpunohen në format Excel. Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit në Bashkinë Skrapar u konstatua që kontabiliteti nuk mbahet në bazë të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara por mbahet në baze të likuidimeve të kryera të dokumentacioneve të shpenzimeve.

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin e rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel" dhe jo me program të veçantë.

- Në përgjithësi janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer

në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, liste pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

#### Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2024 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit 9,877 mijë lekë për shpenzimet dhe 8,705 mijë lekë për të ardhurat. Bazuar në vlerën e materialitetit të përlllogaritur prej 9,877 mijë lekë nga ana e grupit të auditimit u krye verifikimi me zgjedhje për urdhër shpenzimet e periudhës 01.01.2024 deri në 31.12.2024.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” i ndryshuar, për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

#### Procesi i inventarizimit:

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur të tyre. Njësia publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 10 296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në zbatim të Urdhrave të Titullarit të Bashkisë dhe Drejtuesve të 3(tre) Njësive Shpenzuese të Bashkisë Skrapar “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin për vitin 2024”, në secilën njësi shpenzuese është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen konkrete të

aktiveve me gjendjen kontabël, me anëtarë për Bashkinë Skrapar dhe Njësitë e varësisë të cilët paraqiten në aneksin 1/2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Me urdhrin e Titullarit/Drejtuesve të 3(tre) Njësie Shpenzuese të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata”, në secilën njësi shpenzuese është ngritur komisioni përkatës për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata.

Komisioni ka bërë vlerësimin dhe verifikimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata të inventarizuara dhe kanë hartuar proces-verbalin e vlerësimit. Vlera e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.1: Të dhëna për nxjerrjet jashtë përdorimit të mallrave.

**Lekë**

Nr.	Njësia shpenzuese	Aktive të dala nga përdorimi	Llog. 218 "Inv. Ekonomik"		Aktive Afat shkurtër Llog. 327
		Kosto Historike	Kosto Historike	Vlere e mbet.	
1	Bashkia Skrapar(qendra)				
2	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike		115,992		
3	Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor				
Totali			115,992		

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

Nga auditimi i kryer në lidhje me procedurën e vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit u konstatua që komisioni i vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit në Njësinë Shpenzuese të Ndërmarrjes së Shërbimit Publik është ngritur me urdhër të Titullarit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me nr. 67, datë 17.12.2024. Ky komision është i përbërë nga 3(tre) persona. Me proces verbalin e datës 17.12.2024 është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Nr.30, datë, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 95 dhe pika 106 pasi procedura e vlerësimit të gjendjes së aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit është bërë në mënyrë formale. Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e kryer rezultoi se në të njëjtën ditë ka dalë urdhri për ngritjen e komisionit dhe në të njëjtën ditë është mbajtur proces verbali për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit. Proces verbali ka të dhëna të pasakta në lidhje me llojin e mallrave, gjendjen, natyrën e tyre, sasinë dhe çmimin. Proces verbali i vlerësimit të gjendjes së aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit mban datën 17.12.2024 dhe është firmosur nga komisioni i përbërë nga I. O., S. M. dhe E. M. për 56 artikuj në vlerën 1,735,741 lekë dhe është konfirmuar nga Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike z. E. O.

- Me urdhër të Titullarit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike nr. 68, datë 17.12.2024 është ngritur komisioni i asgjësimit të inventarëve të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit i cili me proces verbalin e datës 17.12.2024 ka bërë asgjësimin e inventarëve.

Nga auditimi i kryer në lidhje me procedurën për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit u konstatua se veprimtaria e kryer nga komisioni i asgjësimit të aktiveve është formal, pasi në të njëjtën ditë ka dalë urdhri për ngritjen e komisionit dhe në të njëjtën ditë është mbajtur proces verbali për asgjësimin e aktiveve si dhe proces verbali ka të dhëna të pasakta në lidhje me llojin e mallrave, gjendjen, natyrën e tyre, sasinë dhe çmimin. Vlera e pasqyruar në proces verbal nga komisioni për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit është për 56 artikuj në vlerën 1,735,741 lekë. Parregullsitë në procedurën e kryer për vlerësimin dhe asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit janë konstatuar nga Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Skrapar z. N. G. i cili në përputhje me Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 102, ka pasqyruar në pasqyra financiare për nxjerrjen jashtë përdorimit vetëm vlerën e inventarit ekonomik

prej 115,992 lekë që i përket llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”. Komisioni i asgjësimit për nxjerrjet jashtë përdorimit është i përbërë nga pesë persona dhe konkretisht; E. H., E. K., L. H., M. A. dhe E. K.. Proces verbali i asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit mban datën 17.12.2024 dhe është firmosur nga antarët e komisionit dhe është konfirmuar nga Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike z. E. O.

Nga strukturat drejtuese dhe komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit është vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, neni 8, germa (ç) dhe Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*” i ndryshuar, i ndryshuar, pika 114.

*Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi: Z. E. O. Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve publike dhe Znj. I. O. përgjegjëse e financës pranë kësaj ndërmarrje.*

Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Skrapar, mbahet në mënyrë manuale, gjë që e bën me risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti pasi përdoret programi excel për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të Njësisë dhe njërive të vartësisë. Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Skrapar dhe në njësitë e varësisë, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “*Bartës informatik*”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mos besueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekte. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrigjimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare si dhe në ruajtjen e gjurmës së auditimit, Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. nr. 10 296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, neni 6/d, neni 12/dh, dhe Ligjin nr. 25/2018, “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, nenin 3, pikat 14 e 15 ku citohen se;

“*Dokument kontabël*” është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë...

“*Bartës informatik*” është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë me nenin 11 ku citohet se;

Qëllimi i pasqyrave financiare. 1. *Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njërive ekonomike.* 2. *Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduar.*

*Për veprimet dhe mos veprimet mban përgjegjësi nëpunësi Autorizues z. A. M. dhe z. N. G., në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, ato paraqiten si më poshtë:

**Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasivet**  
Aktivet

**2,448,543,230 lekë**  
2,634,179,428 lekë

Pasivet 185,636,198 lekë  
Aktivet Neto 2,448,543,230 lekë

**Aktivet afatshkurtra.**

Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën 275,267,489 dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në vlerën 96,856,465 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në vlerën 29,655,031 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në vlerën 148,755,993 lekë.

Të detajuara këto llogari paraqiten në aneksin 1/3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**A. AKTIVET**

**I. Aktivet Afat Shkurtra**

- Llogaritë e klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” të detajuara paraqiten në aneksin 1/4, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tabela nr. 2: Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Ndryshimi 2024-2023
520	Disponibilitete ne Thesar	96,856,465	113,122,065	-16,265,600

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

- **Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 113,122,065 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 96,856,465 lekë me një ndryshim në zbritje krahasuar me ushtrimin paraardhës në vlerën 16,265,600 lekë. Kjo llogari kuadron me shumen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 59,976,260 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 36,880,205 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me akt rakordimet me thesarin rezulton se, të ardhurat që trashëgohen për vitin pasardhës sipas akt rakordimit me thesarin janë në vlerën 59,976,260 lekë. Sipas akt rakordimit për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” janë në vlerën 36,571,010 lekë. Nga auditimi u konstatua që llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar ne pasqyrën e pozicionit financiar te konsoliduar ne vlerën 36,880,205 lekë ose 309,195 lekë me shume se akt rakordimi me thesarin. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme: nënpika 28, 29 “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet me vete), para evidentimit të dhënave ne pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore”.

Me pas, bëhen rakordimet përkatëse te aktiveve dhe te detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur ne dokumentacionin kontabël te prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje te ndodhur për periudhën raportuese.”

Për veprimet dhe mos veprimet mban përgjegjësi z. N. G., në cilësinë e nëpunësit zbatues.

**2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Tabela nr. 3: Të dhëna për llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024/lekë	31.12.2023/lekë	Ndryshimi 2024-2023/lekë
31	Materiale	3,157,324	2,396,378	760,946

32	Inventar i imët	24,687,555	23,790,781	896,774
33	Prodhim në proces	1,810,152	1,333,766	476,386
Totali		29,655,031	27,520,925	2,134,106

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqiten në vlerën 29,655,031 lekë dhe përbëhen nga; llogaria kontabël 31 “*Materiale*” në vlerën 3,157,324 lekë; llogaria 32 “*Inventar i imët*” në vlerën 24,687,555 lekë dhe llogaria 33 “*Prodhim në proces*” në vlerën 1,810,152 lekë.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime për të cilat u kërkua dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion, në përgjithësi, për të gjitha shpenzimet disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës)
- Fletë hyrje në magazinë
- Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës)
- Fletë dalje nga magazine.
- Llogaria 31 “*Materiale*”, paraqitet në vlerën 3,157,324 lekë.

Nga auditimi i kryer në lidhje me paraqitjen e drejtë në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar të llogarive kontabël të inventarëve rezulton se; Njësia Shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka paraqitur në pasqyra të saj gabimisht në llogarinë 32 “*Inventarë i imët*” vlerën prej 1,414,995 lekë kur kjo vlerë duhej të paraqitej në llogarinë 31 “*Materiale*” dhe ka paraqitur gabim në llogarinë 33 “*Prodhim në proces*” vlerën prej 1,810,152 lekë kur kjo vlerë duhej të paraqitej në llogarinë 32 “*Inventarë i imët*”. Të dhënat për llogaritë e inventarëve sipas njësive të vartësisë paraqiten në aneksin 1/5, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Aneksi 1, pika 3.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 3, “*Aktivet afatshkurtra jo financiare (inventarët)*” dhe Kapitulli III. “*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

*Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi z. N. G. nëpunës zbatues dhe Znj. I. O. Përgjegjëse e Financës në NSHP.*

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në përgjithësi gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Titullari i Bashkisë Skrapar ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*”.

### 3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhen nga:

Tabela nr. 4: Të dhëna për llogaritë e klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”.

		Lekë		
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Ndryshimi 2024-2023
468	Debitorë te ndryshëm	122,719,872	108,619,584	14,100,288

4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	26,036,121	18,158,458	7,877,663
Totali		148,755,993	126,778,042	21,977,951

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” më datë 01.01.2024, është paraqitur në vlerën 108,619,584 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më date 31.12.2024, është paraqitur në vlerën 122,719,872 lekë me një rritje në vlerën 14,100,288 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se; Në llogarinë 468“*Debitorë të ndryshëm*” nuk janë pasqyruar debitorët nga kontrata e qirasë të fondit pyjor kullosorë. Subjekte që nuk kanë likuiduar detyrimet për vitin 2024 janë në vlerën 2,837,420 lekë dhe konkretisht; për kontratën e lidhur me subjektin “O.”, vlera e detyrimit të papaguar prej 35,000 lekë, për kontratën e lidhur me subjektin “HPP V. E.”, vlera e detyrimit të papaguar prej 138,245 lekë; për kontratën e lidhur me subjektin “M. E.”, vlera e detyrimit të papaguar prej 2,664,175 lekë. Debitorët në vlerën 2,837,420 lekë(35,000 +138,245 +2,664,175) nuk janë përfshirë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në rakordimin e bërë me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet drejtorive përkatëse. Nga auditimi konstatohen të ardhura të munguara në vlerën 2,837,420 lekë si pasojë e mos paraqitjes së saktë të llogarisë 468“*Debitorë të ndryshëm*” në fund të vitit 2024. Marrëdhënia shkresore midis strukturave të bashkisë që ka të bëjë me rakordimet në lidhje me debitorët është bërë me shkresa të pa protokolluara në zyrën e protokoll arshivës. Këto shkresa nuk kanë tërësinë e elementeve të përcaktuara ligjërisht në nenet 11-20 të “*Norma tekniko-profesionale*”.

Këto veprime janë në kundërshtim me në kundërshtim me me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “*Për arkivat*”, neni 22 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

*Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi z. N. G. nëpunës zbatues dhe Znj. H. B. Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.*

Nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “*Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë*”.

Sipas të dhënave të pozicionit financiar të Bashkisë Skrapar qendër dhe balanceve të njësisë të varësisë e krahasuar me të dhënat e llogarive sipas thesarit situata paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.5: Krahasimi i llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” me të dhënat e thesarit.

**Lekë**

Institucioni	Skrapar (qendër)		Nd.Sherb.Publike		Nder. sherb. pyjor	
	Pasqyra PF	Thesari	Pasqyra PF	Thesari	Pasqyra PF	Thesari
Llog.468 “ <i>Debitorë të ndryshëm</i> ”	115,916,958	115,916,958	6,802,914	0	0	0

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Nga auditimi i pozicionit financiar të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” u konstatua që në pasqyrat financiare të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është paraqitur vlera prej 6,802,914 lekë, ndërkohë që të dhënat e kësaj llogarie sipas thesarit rezultojnë në vlerën prej zero lekë ose pasqyruar më shumë në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 6,802,914 lekë (6,802,914-0). Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” nuk rakordon me llogaritë e pasqyruara në thesar për vlerën prej 6,802,914 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar*”

dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”; me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. “Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: *Këto pasqyra iu dërgohen njërive të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit, Paragrafi 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njërive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.*

Situata e llogarive të klasës 4 dhe përkatësisht llogaria 468“Debitorë të ndryshëm” dhe llogaria 4342“Operacione me shtetin(Te drejta)” sipas pasqyrimit në pasqyra të konsoliduar dhe pasqyra të njërive shpenzuese paraqitet si në vijim:

Tabela nr.6: Të dhëna te llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Lekë

Nr.	Institucioni	Llogaria 468			Llogaria 4342		
		Është	Duhet	Diferenca	Është	Duhet	Diferenca
1	Bashkia Skrapar (qendër)	115,916,958	115,916,958	0	24,115,957	24,115,957	0
2	Ndërmarrja e shërbimeve publike	6,802,914	0	6,802,914	0	6,802,914	-6,802,914
3	Ndërmarrja e shërbimit pyjor	0	0	0	1,920,164	1,920,164	0
4	Bashkia Skrapar bilanci i konsoliduar	122,719,872	115,916,958	6,802,914	26,036,121	32,839,035	-6,802,914

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Nga auditimi i kryer në lidhje me paraqitjen e drejtë në pasqyrat e konsoliduar sipas pozicionit financiar rezulton se; Njësia Shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka paraqitur në pasqyra të saj gabimisht në llogarinë 468“Debitorë të ndryshëm” vlerën prej 6,802,914 lekë (që vjen e mbartur nga ushtrimi i mëparshëm në vlerën 6,145,850 lekë), kur kjo vlerë duhej të paraqitej në llogarinë 4342“Operacione me shtetin(Te drejta)”. Për rrjedhojë ka një gabim në paraqitjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 6,802,914 lekë.

E analizuar llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për periudhën në auditim, sipas të dhënave nga Bashkia Skrapar, paraqiten në aneksin 1/6, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “i ndryshuar, Kapitulli III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi N. G. nëpunës zbatues dhe Znj. I. O. Përgjegjëse e Financës në NSHP.

Llogaria 4342“Operacione me shtetin (te drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 18,158,458 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024 në vlerën 26,036,121 lekë. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është një llogari që në pasqyrat financiare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme. Bazuar në të dhënat e pasqyrës

së pozicionit Financiar llogaria 4342 në fund të vitit 2024 duhej të përmbajë llogaritë si më poshtë vijon:

Tabela nr.7: Llogaritë kundër parti të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin të drejta”

Nr	Llogaria	Përshkrimi	Vlera/lekë
1	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	26,036,121
	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	4,316,066
	42	Detyrime ndaj personelit	20,638,947
	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,748,683
	435	Sigurime Shoqërore	5,420,627
	436	Sigurime Shëndetësorë	714,712
2	Totali	(401-408)+42+431+435+436	32,839,035
3	Diferenca(1-2)	4342-[(401-408)+42+431+435+436]	-6,802,914

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Nga përlllogaritjet e grupit te auditimit kundër partia e llogarisë 4342“*Operacione me shtetin të drejta*” janë në vlerën 32,839,035 lekë. Ndryshimi midis pasqyrimt të llogarisë 4342 “*Operacione me shtetin të drejta*” me vlerën e sajë në fund të vitit 2024 sipas përlllogaritjeve është për vlerën prej - 6,802,914 lekë (26,036,121 -32,839,035).

Të detajuara përlllogaritjet për llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin të drejta*” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/7, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 4342 “*Operacione me shtetin të drejta*” e pasqyruar në fund të vitit 2024 në vlerën 26,036,121 lekë është nënvlerësuar për vlerën 6,802,914 lekë dhe nuk kuadron me kundër partitë e saj që janë llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari te lidhura me to*”, llogaria 42 “*Detyrime ndaj personelit*”, llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*”, llogaria 435 “*Sigurime Shoqërore*”, llogaria 436 “*Sigurime Shëndetësorë*”. Nga analiza e kryer rezulton se njësia shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimeve Publike(NSHP) e ka paraqitur llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin të drejta*” në fund të vitit 2024 në vlerën 0 lekë kur kundër partitë e saja janë në vlerën 6,802,914 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar kreu “*Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin*”. Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive kontabël të 4342“*Operacione me shtetin të drejta*” germa b) “*Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”*; Kreditohet llogaria 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Z. N. G. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar nëpunës zbatues dhe Znj. I. O. Përgjegjëse e Financës në NSHP.*

Gjendja e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 26,036,121 lekë në pasqyrën e pozicioni financiar të konsoliduar, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 1,920,164 lekë në pasqyrën e Performances Financiare. Analiza më sipër, në mënyrë të detajuar sipas njësive të varësisë dhe bilancit të konsoliduar paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.8: Të dhëna për llogarinë “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Nr.	Institucioni	Lekë				
		Llogaria	Vlera	Llogaria	Vlera	Diferenca
		1	2	3	4	5=(4-2)
1	Bashkia Skrapar (qendër)	7206	0	4342	24,115,957	24,115,957
2	Ndërmarrja e shërbimeve publike	7206	0	4342	0	0

3	Ndërmarrja e shërbimit pyjor	7206	1,920,164	4342	1,920,164	0
4	Bashkia Skrapar bilanci i konsoliduar	7206	1,920,164	4342	26,036,121	24,115,957

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Diferenca prej 24,115,957 lekë konstatohet në pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar (qendër).

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese kreu Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin. Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive kontabël të 4342 “Operacione me shtetin të drejta” germa b) “Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”; Kreditohet llogaria 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar z. N. G. Nëpunës zbatues.

Nga auditimi konstatohet se: Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

## II. AKTIVET AFAT GJATA

Të dhëna për llogaritë e Aktiveve Afatgjata për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/8, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

### 1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

- **Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 74,449,221 lekë (vlerë kontabël neto). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 0 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 11,167,383 lekë, ka pasur pakësim në vlerën zero lekë dhe më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 75,254,169 lekë (vlerë kontabël neto).

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/9, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të dhënat analitike e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” rezultojnë 25 studime dhe projektme të pasqyruara në vlerën e tyre historike 106,814,857 lekë.

Të dhënat analitike të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/10, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Konstatohet që nga të dhënat e llogarisë 230-231 në pasqyrën e pozicionit financiar nuk paraqitet asnjë objekt që të jetë në proces pasi kapitalizimi i aktiveve është kryer sipas likuidimeve pjesore vjetore dhe jo sipas përfundimit të objekteve dhe aktet e marrjes në dorëzim të tyre. Studimet dhe projektmet, llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, për objektet e përfunduara duhet te kapitalizoheshin në shtesat të llogaritë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe në llogarinë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”. Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” nuk duhej të paraqitej me vlerën e saj neto prej 75,254,169 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 pasi nuk paraqet situatën e saktë dhe të drejte të saj.

Të dhënat të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” sipas njësive të vartësisë, paraqiten në aneksin 1/11, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua që në përbërje të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” janë 6 (gjashtë) projekte të cilat lidhen me ujësjellës që duhet ti bashkëngjiten kapitalizimit të aktiveve dhe të transferohen në “Sh. R. U. K. B. Sha” me NIPT. M....O.

Të dhënat analitike të llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” për 6(gjashtë) projekte të cilat lidhen me ujësjellës, paraqiten në aneksin 1/12, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura*” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Nga verifikimi i të dhënave në lidhje me objektet e përfunduara rezulton se nuk ka informacion në lidhje me përfundimin e objekteve që u përkasin 13 projektet në vlerën 14,852,624 lekë.

Të dhënat analitike të llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” për 13 projektet në vlerën 14,852,624 lekë, paraqiten në aneksin 1/13, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kjo ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu II “*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Aneksi 1 “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*” pika 2, klasa 2, “*Aktivet afatgjata*” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar z. N. G., Nëpunës zbatues.*

## **2. Aktivet Afatgjata Materiale.**

- **Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 4,243,818 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa/pakësim, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,243,818 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/14, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga verifikimi dhe analiza e Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*”, konstatohet se, nga ana e Drejtorisë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të;

a) trojeve nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në Njërive Administrative, etj., sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”.

truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, si dhe nuk është kryer

inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 “*Toka, troje terrene*” rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024.

Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 “*Toka, troje terrene*” dhe paraqitja e

gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të.

E pa analizuar kjo llogari ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

- **Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 6,911,988 lekë (vlera e mbetur). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësim, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 6,911,988 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/15, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se në llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, është pasqyruar vetëm “Pyllëzimi Kurorës së Qytetit të Çorovodës” në vlerën 6,911,988 lekë. Bashkia në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Skrapar, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Skrapar, me numër rendor nga 1 (një) deri 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy) dhe godinën e DSHP-së.

Për këto sipërfaqe nuk është bërë verifikimi fizik i tyre me qëllim përcaktimin e vlerës kontabël të llogarisë nr. 211. Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për llogarinë me sipër.

Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Skrapar nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Pra, si rezultat i moszbatimit të kuadrit rregullator ligjor për transferimin e aktiveve, llogaria 211 “Pyje Plantacione”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 “Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap III, pika 30, i ndryshuar.

*Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi Drejtor i Drejtorisë Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G. dhe Drejtor i Drejtorisë Shërbimit Pyjor B. D..*

- **Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”** në datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 616,406,316 lekë (vlera e mbetur). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 19,344,566 lekë pakësim zero lekë dhe amortizim të vitit në vlerën 30,820,316 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 604,930,566 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/16, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shtesat e vitit 2024 në vlerën 19,344,566 lekë i përket 5 (pesë) objekteve të mara në dorëzim, të cilat të detajuara, paraqiten në vijim.

Tabela nr.9: Të dhëna për shtesat e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione”.

Nr.	Llog. 212 "Ndërtesa e Konstruksione"	Vlera/lekë
1	Bashkëfinancim Ne Objektivin Rikonstruksioni Gjinnazit Çorovode	6,475,057
2	Mbikëqyrje Ne Objektivin Rikonstruksioni Gjinnazit Çorovode	547,051
3	Kolaudim Ne Objektivin Rikonstruksioni Gjinnazit Çorovode	48,300
4	Kolaudim Ne Objektivin Rikonstruksioni Gjinnazit Çorovode	45,275
5	Rikonstruksioni Shkollës Ramis Aranitasi Çorovode	12,228,883
Totali		19,344,566

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

Nga auditimi i llog.(212) në lidhje me kontabilizimin e tyre konstatohet se për një numër të konsiderueshëm objektsh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre pasi janë të trashëguar nga ish komunat ka pasaktësi në pasqyrimin në kontabilitet në lidhje me sipërfaqen, gjendjen e tyre, truallin nën objekt dhe sipërfaqet rrethuese. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/komunat) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Duke qenë se ka mospërputhje dhe pasaktësi në administrimin për çdo objekt të llogarisë 212 “Ndërtesave e Konstruksioneve” nga Bashkia Skrapar, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, duhet që të bëhet verifikimi dhe hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt.

Sa trajtuam më sipër Llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024. Nga titullari i Bashkisë Skrapar, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap III, pika 30, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi Drejtor i Drejtorisë Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G. dhe Specialist i Administrimit të Aseteve z. B. D.

- **Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** në datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 1,549,907,586 lekë(vlerë e mbetur). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 74,955,109 lekë.

Llogaria 213 gjatë vitit 2024 është pakësuar vetëm nga amortizimi i vitit në vlerën lekë. Gjendja e kësaj llogarie në 31.12.2024 paraqitet në vlerën 1,541,399,602 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/17, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shtesat e vitit 2024 në vlerën 74,955,109 lekë i përkasin 6(gjashtë)objekteve të mara në dorëzim të cilat të detajuara paraqiten në aneksin 1/18 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” konstatohet që Bashkia Skrapar ka në inventar 40 objekte ujësjellësve me kosto historike në vlerën 768,622,055 lekë të cilat të detajuara paraqiten në aneksin 1/19 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se;

Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të

ujësjellësit në “Sh R U K B Sha” me NIPT M..O në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe nga informacioni i marrë konstatohet se, gjendja e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në 19(nëntëmbëdhjetë) objekte në vlerën 154,441,820 lekë është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. E pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

*Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi Drejtor i Drejtorisë Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..*

- **Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** në datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 20,568,565 lekë(vlerë e mbetur). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 333,800 lekë, pakësim në vlerën zero lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 5,088,379 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 15,813,986 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/20, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shtesat e vitit 2024 në vlerën 333,800 lekë përbëhen nga blerje makinë korrëse bari, etj.

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 69,197,230 lekë(vlerë e mbetur). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa. Amortizimi vjetor është në vlerën 13,839,446 lekë dhe në datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 55,357,784 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/21, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në këtë llogari Bashkia Skrapar ka klasifikuar mjetet e transportit të llojeve të ndryshme që disponon në funksion të realizimit të veprimtarisë së saj në shërbim të komunitetit.

- **Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 16,723,912 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 5,375,270 lekë, pakësim në vlerën 115,992 lekë, nga të cilat nga nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 115,992 lekë. Amortizimi vjetor i llogaritur është në vlerën 3,543,986 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 18,439,204 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/22, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shtesat e vitit 2024, në vlerën 5,375,270 lekë, përbëhen nga; blerje tavolinash, karrige, dollap, rafte të ndryshëm, etj., ndërsa pakësimi ka të bëjë me nxjerrjet jashtë përdorimit në vlerën 115,992 lekë.

- **Llogaria 28 “Caktime te Aktiveve Afatgjata”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 36,560,822 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 0 lekë, pakësim në vlerën 0 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 36,560,822 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 28 “*Caktime te Aktiveve Afatgjata*”. për periudhën në auditim,

paraqiten në aneksin 1/23, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në këtë llogari janë pasqyruar aktivet që u janë caktuar njësisve shpenzuese të vartësisë dhe konkretisht NSHP, që të detajuara janë si më poshtë vijon:

Tabela nr.10: Të dhëna analitike për llogarinë 28 “Caktime te Aktiveve Afatgjata”.

Nr	Emërtimi	Vlera/lekë
1	Kosha për mbetjet e qytetit	3,499,998
2	Kurrize Artificiale për ngadalësim Shpejtësie	2589600
3	Kamion 5 cp, fadroma 2 cop, eskavatorë 1cp	30,471,224
Totali		36,560,822

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

### 3. Aktive afatgjata financiare.

- **Llogaria 25 “Huadhënie e nën huadhënie”**. Në këtë llogari nuk janë kryer veprime e për rrjedhojë gjendja e sajë në pasqyrat e pozicionit financiar paraqitet në vlerën zero lekë.

- **Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e veta”** më datën 01.01.2024, është paraqitur në vlerën 0 lekë dhe në datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Bashkia Skrapar është aksionarë në Shoqërinë e re të krijuar “*Sh. R. U. K. B. Sha*” me NIPT. M..O. shoqëri e krijuar në bazë të akt marrëveshjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfaqësuar nga AKUM me nr.7183.prot., datë 28.09.2022 dhe Bashkitë Berat, Kuçovë, Dimal, Poliçan dhe Skrapar. Bazuar në këtë akt-marrëveshje kapitali fillestar i shoqërisë është 10,000,000 lekë ku Bashkia Skrapar zotëron 4,7% të aksioneve ose në vlerë kapitali 470,000 lekë (10,000,000\*4,7%).

Nga auditimi konstatohet që Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave e Bashkisë Skrapar nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në Shoqërinë e re të krijuar “*Sh. R. U. K. B. Sha*” me NIPT. M..O. për vlerën prej 470,000 lekë. Llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vetë*”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura*” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..*

- **Llogaria 230 “Për aktive afatgjata jo materiale”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 11,972,331 lekë dhe pakësim në vlerën 11,972,331 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 230 “*Për aktive afatgjata jo materiale*”. për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/24, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 100,008,745 lekë dhe pakësim në vlerën 100,008,745 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë.

Të dhëna për lëvizjen e llogarisë 231 “*Për aktive afatgjata materiale*”. për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/25, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shtesat dhe pakësimi për këto llogari për periudhën në auditim paraqiten të detajuara në aneksin 1/26, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i shtesave të aktivitetit për vitin 2024 sipas pasqyrës anekse statistikore nr.7/a u konstatua që shtesat e aktivitetit për blerje me pagese për vitin 2024 janë në vlerën 111,981,076 lekë vlere e cila përputhet me vlerën kreditore të llogarisë 230-231 “Shpenzime për investimet afatgjata materiale dhe jo materiale” paraqitur në pasqyrën anekse statistikore n.6 “Investimet dhe burimet e financimit”. E detajuar shtesa e aktivitetit për blerjet me pagesë për vitin 2024 paraqitet si më poshtë vijon.

Tabela nr.11: Të dhëna të detajuara për shtesat e aktivitetit .

Lekë

Nr. i llog.	Emërtimi i llogarisë	Shtesa e Aktiviteti viti 2024 (blerje e krijuar me pagese)
202	Studime dhe kërkime	11,972,331
212	Ndërtime e Konstruksione	19,344,566
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	74,955,109
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	333,800
218	Inventar ekonomik	5,375,270
	<b>TOTALI</b>	<b>111,981,076</b>

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Nga auditimi i të dhënave të thesarit për vitin 2024 u konstatua që vlera debitorë e llogarisë 230-231 “Shpenzime për investimet afatgjata materiale dhe jo materiale” përputhet me të dhënat e realizimeve të shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 vlere e cila është 111,981,076 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që llogaritë 230-231 “Investimet” është në vlerën zero lekë rrjedhimisht nuk është paraqitur asnjë investim që është në proces. Nga tërësia e veprimeve kontabël sipas pasqyrave financiare dhe anekseve statistikore rezulton që nuk është paraqitur asnjë investim që është në proces zbatimi rrjedhimisht të gjitha investimet janë paraqitur të përfunduara. Nga analiza e kryer rezulton që në 31.12.2024 investimet në proces për të cilat grupit të auditimit nuk ju paraqiten certifikata të marrjes në dorëzim janë si më poshtë:

Tabela nr.12: Të dhëna për investime në proces.

Nr	Emërtimi	Vlera/në lekë
1	Investim pagesa e situacioni nr.1 "rehabilitimi urban ne te dy anet e rruges a. Kasemi"	7,927,234
2	Investim pagesa e situacioni nr.2 "rehabilitimi urban ne te dy anet e rruges a. Kasemi"	9,953,040
3	Rehabilitimi urban ne te dy anet e rruges "arkitekt kasemi"- financimi situacionit perfundimtar	10,660,017
4	Mbikqyrje punimesh ne objektin: rehabilitim ne dy anet e rruges "arkitekt kasemi"	627,649
5	Kolaudim punimesh ne objektin: rehabilitim ne dy anet e rruges "arkitekt kasemi"	104,500
6	Mbrojtje ure mbi lumin e tomorrices, krahu i majte dhe i djathte ne hyrje dhe dalje situacini nr.1	17,661,840
7	Mbrojtje ure mbi lumin e tomorrices, krahu i majte dhe i djathte ne hyrje dhe dalje situacini nr.2	4,368,600
8	Mbrojtje ure mbi lumin e tomorrices krahu majte dhe i djathte ne hyrje dhe dalje sit.nr.3	19,299,829
	<b>Totali</b>	<b>70,602,709</b>

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ndjek parimet e kontabilizimit të shtesave të aktiveve të qëndrueshme në bazë të procesit të përfundimit të objekteve sipas akteve të marrjes në dorëzim të objekteve dhe vlerave të situacioneve përfundimtare moment ky i pakësimit të vlerave të llogarisë 230-231, por kalon në shtesat e aktiveve të qëndrueshme vlerat e likuiduara gjatë vitit të punimeve në proces. Për sa më sipër nuk ruhet gjurma e auditimit në lidhje me procesin e kontabilizimit të pakësimit të llogarisë 230 - 231 “Investime në proces” në shtesat e llogarive të aktiveve të qëndrueshme jo materiale dhe materiale përkatësisht llogaritë 202, 212, 213, 214.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2. Njohja e AAGJ në pasqyrat financiare vjetore. Hyrjet e AAGJM dokumentohen: “Për blerjet, ku si dokumente shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt- marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit. Për përfitimet nga dhurime, ku si dokument është akti i dhurimit dhe akti i marrjes në dorëzim. Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim. Për rivlerësimet, shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..*

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqiten në total në vlerën 0 lekë, e cila kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë, llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë dhe llogarisë 106 “Teprica e Granteve kapitale, Të Huaja”. Këto veprime janë në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, germa “c”.

#### **• Auditim mbi administrimin e aseteve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Skrapar duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,

a. Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje e vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se nga Bashkia Skrapar nuk është hartuar regjistër kontabël i përditësuar për aktivitetet që zotëron apo ka në administrim bashkia dhe njësitë administrative në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajtjes kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj., veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26-33.

Në inventar të Bashkisë Skrapar janë transferuar pasuri, të cilat paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.13: Të dhëna për pasuritë e transferuara ne Bashki me VKM.

Nr.	Bashkia/Njësiti	Nr. Pronave në Inventar	Listë përfundimtare/jo përfundimtare sipas VKM
1	Bashkia Skrapar	976	Përfundimtare
2	Ish Komuna Cepan	482	Jo-Përfundimtare
3	Ish Komuna Vendreshë	215	Jo-Përfundimtare
4	Ish Komuna Leshnjë	187	Jo përfundimtare
5	Ish Komuna Gjrbës	155	Jo përfundimtare
6	Ish Komuna Potam	98	Përfundimtare
7	Ish Komuna Bogovë	420	Përfundimtare
8	Ish Komuna Qendër	627	Përfundimtare
9	Ish Komuna Zhepë	459	Jo-Përfundimtare
10	Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri	1	Përfundimtare

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Planifikim Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

b. Me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive”, i janë kaluar në pronësi sipërfaqe:

Gjithsej 26,286.87 ha, nga këto:

Pyje 24,452.07 ha,

Kullotë 11,195.2 ha

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se pronat e mësipërme nuk janë regjistruar në ASHK.

c. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 18 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie. Nga të dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nuk ka pasur regjistrim të pasurive në DV ASHK Skrapar për vitin 2024. Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk kanë marrë masat për hartimin e planeve të rlevimit, verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së si dhe parashikimin e fondeve për pagesën e plan rlevimeve për cdo pronë publike për të cilën do të aplikohet, për të bërë të mundur regjistrimin e pronave të paluajtshme që janë brenda juridiksionit të Bashkisë Skrapar dhe njësive të tyre administrative, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020 dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësiti e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35- 36, për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor.

- **Amortizimi dhe Llogaritja e tij.**

Llogaritja e amortizimit dhe normat e amortizimit të përdorura për periudhën objekt auditimi janë si në vijim.

Tabela nr.14: Normat e amortizimit në përqindje.

Llog.	Emërtimi	Norma e amortizimit
202	Studime dhe kërkime(lineare)	15%
213	Rruge, rrjete, vepra ujore, ndërtesa	5%
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	25%
215	Mjete transporti	20%
218	Inventar ekonomik	20%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

Nga auditimi i zbatimit të normave të amortizimit në përputhje me kuadrin rregullatorë në fuqi u konstatua se: Llogaritja e amortizimit për aktivet jo materiale është bërë në përputhje me; Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar.

Të dhëna për llogaritjen e amortizimit sipas llojit të aktiveve për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/27, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

## **B. PASIVET (DETYRIMET)**

### **I. Pasivet Afatshkurtra**

#### **1. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Skrapar më datën 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit Dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,. Të dhëna për llogaritë e pagueshme për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/28, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhësja e llogarive 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” paraqitet në vlerën 4,316,066 lekë, llog. 42 “*Detyrime ndaj personelit*” në vlerën 20,638,947 lekë, llog. 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” në vlerën 1,748,683 lekë, llog. 435 “*Sigurime shoqërore*” në vlerën 5,420,627 lekë, llog. 436 “*Sigurime shëndetësore*” në vlerën 714,712 lekë dhe llog. 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në vlerën 0 lekë ku totali shkon në vlerën 32,839,035 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin (Të drejta)*” në vlerën 26,036,121 lekë jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Aneksi 1.

**-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** më datë 01.01.2024, është në vlerën 1,611,307 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 4,316,066 lekë dhe pakësim në vlerën 1,611,298 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,316,066 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, paraqitet në aneksin 1/29, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në pasqyrat financiare të konsoliduar është paraqitur në vlerën 4,316,066 lekë që përben detyrimet e bashkisë për fatura të mbërritura të pa paguara. Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” është paraqitur në vlerën prej zero lekë në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar. Nga auditimi i të dhënave për detyrimet e prapambetura të Bashkisë Skrapar (Qendër) u konstatua që me shkresën nr.480.prot., datë 10.02.2025 për dërgimin e Raportit të Vetëvlerësimit Financiar për vitin 2024 dhe paraqitjen pranë Ministrisë së Financave të “*Detyrimeve ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësisë Financiare*” janë paraqitur detyrime të prapambetura ndaj të tretëve vlera prej 12,137,246 lekë dhe vlera 595,320 lekë për detyrime për kontrata të lidhura nga Ministritë e Linjës. Në total detyrime të prapambetura të paraqitura në Ministrinë e Financave sipas të dhënave të detajuara janë në vlerën 12,732,566 lekë të cilat paraqiten të detajuara në aneksin 1/34, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga tërësia e të dhënave të raportuara në Ministrinë e Financave për llogarinë 4864 “*Detyrime të prapambetura*” u konstatua që në pasqyrat e pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar

janë pasqyruar më pak detyrime të prapambetura në vlerën 8,416,500 lekë (12,732,566-4,316,066) ku vlera prej 4,316,066 lekë është vlera e pasqyruar në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”. Nga auditimi u konstatua që llogaria 467 “Kreditorë te ndryshëm” është nënvlerësuar për vlerën prej 8,416,500 lekë (12,732,566 - 4,316,066).

Të dhëna për llogarinë 4864 “Detyrime të prapambetura” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/30, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Këto janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Pika 15 Seksioni 3.1 “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Paragrafi 42 ndryshon si vijon:

“Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njërive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin Llogarinë kontabël 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njërive të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në Llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me këto të fundit.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së Llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së Llogarisë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura” në debi të Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto Llogari.....”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..

**-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 20,638,947 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës. Sipas të dhënave të pozicionit financiar të Bashkisë Skrapar qendër dhe bilanceve të njërive të varësisë e krahasuar me të dhënat e llogarive sipas thesarit kjo llogari paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.15: Krahasimi i llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” me të dhënat e thesarit.

**Lekë**

Institucioni		Skrapar (qendër)		Nd.Sherb.Publike		Nder. sherb. pyjor	
Llogaria	Emërtimi	Pasqyra PF	Thesari	Pasqyra PF	Thesari	Pasqyra PF	Thesari
42	Detyrime ndaj personelit	13,896,250	13,596,250	5,390,320	5,390,320	1,352,377	1,352,377

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Nga auditimi i pozicionit financiar të llogarisë Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” u konstatua se në pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar (Qendër) është paraqitur vlera prej 13,896,250 lekë ndërkohe që sipas të dhënave të kësaj llogarie sipas thesarit kjo llogari rezulton në vlerën 13,596,250 lekë ose pasqyruar me shume në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën prej 300,000 lekë (13,896,250-13,596,250). Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” është mbivlerësuar për vlerën prej 300,000 lekë. Në pasqyrën e pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar duhej të paraqitej në vlerën 20,338,947 lekë dhe është paraqitur në vlerën 20,638,947 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh” dhe me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për

disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

“Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njësisive të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësisive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..

-**Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 1,748,683 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj Shtetit për muajin Dhjetor.

-**Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin Janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 5,420,627 lekë.

-**Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin Janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerën 714,712 lekë.

-**Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Skrapar në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 36,880,205 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5% dhe vlerën e taksës së pullave. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Skrapar. Lëvizjet e llogarisë për periudhën objekt auditimi paraqiten në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.16: Shtesat dhe pakësimet e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2024	43,925,700
Shtesa (K)	3,912,204
Pakësime (D)	10,957,699
Gjendja debitoare në 31.12.2024	36,880,205

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

Të dhënat analitike të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” për periudhën në auditim, paraqiten në aneksin 1/31, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Fonde që u përkasin objekteve të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Skrapar janë në vlerën 36,571,010 lekë. Një pjesë e fondeve që gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Skrapar i përkasin periudhave të mëparshme të trashëguara nga ish komunat dhe në vazhdim, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës është rakorduar me Degën e Thesarit Skrapar në lidhje me vlerën e trajtuar më sipër. Nga Drejtoria e financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,571,010 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Kjo ka ndodhur pasi nuk ka patur bashkëpunim midis Drejtorisë së Planifikimit-Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe

Drejtorisë së Menaxhimit Financiar Dhe të Ardhurave në lidhje me njoftimin e subjekteve sipas llojit të investimit të kryer. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50, me pikën 3.2, Llogaria 466 “Kreditor për mjete në ruajtje” e UMFE nr.5, datë 21.02.2022 dhe me UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10, ku përcaktohet që:

Pika 29. *Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese.*

Pika 30. *Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet.*

Pika 39. *Këto pasqyra i’u dërgohen njërive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit, me qëllim përgatitjen dhe rakordimin e pasqyrave financiare të 10 njësisë me informacionin që gjendet në SIFQ. Në këtë mënyrë, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, rakordojnë të dhënat e tyre në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor që kanë përgatitur me pasqyrat e mësipërme të gjeneruara nga SIFQ-i.*

Pika 50. *Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).*

Pika 10. *Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.*

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..*

**-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin(detyrime)”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Skrapar në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 115,916,958 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” e cila nuk figuron as në llogaritë e pasqyrës së pozicionit financiar dhe as në llogarite e rakordimit me thesarin.

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” paraqitet në vlerën prej 115,916,958 lekë.

Tabela nr.17: Krahasimi i të dhënave të llogarive 4341, 468, 470.

Nr.	Llogaria	Përshkrimi i llogarisë	Vlera/lekë
1	4341	Operacione me shtetin( detyrime)	115,916,958
2	468	Debitorë te ndryshëm Fund 2024	115,916,958
3	468	Debitorë te ndryshëm Fillim 2024	102,473,734
4	470	Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë duhet paraqitur(2-3)	13,443,224
3	4341	Ndryshimi ne pasqyrim (1-3)	102,473,735

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Skrapar/përpunoi grupi i auditimit..

Duke marrë në konsideratë edhe konstatimet e bëra në trajtimin e llogarisë 468 “*Debitor të, ndryshëm*” rezulton se gjendja e saj në 01.01.2024 është në vlerën 102,473,734 lekë dhe është shtuar gjatë vitit me shumën 13,443,224 lekë. Llogaria 468 “*Debitor të, ndryshëm*” për vlerën e shtuar të debitorëve të vitit 2024 prej 13,443,224 lekë nuk ka në kundër parti të sajë llogarinë 470 “*Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë*”. Nga auditimi u konstatua që llogaria 4341 është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 115,916,958 lekë dhe duhej pasqyruar 102,473,734 lekë që është vlera e debitorëve të viteve të mëparshme që rezultojnë para vitit 2024. Llogaria 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*” është mbivlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë (115,916,958-102,473,734) ndërsa llogaria 470 “*Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë*” është nënvlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë që është shtesa e debitorëve për vitin 2024.

Konkluzion: Nga auditimi pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria 470 “*Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë*”. Për vitin 2024 gjendja në fillim e llogarisë 468 “*Debitor të, ndryshëm*” është në vlerën 102,473,734 lekë dhe është shtuar gjatë vitit me shumën 13,443,224 lekë. Llogaria 468 “*Debitor të, ndryshëm*” për vlerën e shtuar të debitorëve të vitit 2024 prej 13,443,224 lekë nuk ka në kundër parti të sajë llogarinë 470 “*Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë*”. Nga auditimi u konstatua që llogaria 4341 është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 115,916,958 lekë dhe duhej pasqyruar në vlerën 102,473,734 lekë që është vlera e debitorëve të viteve të mëparshme që rezultojnë para vitit 2024. Llogaria 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*” është mbivlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë (115,916,958-102,473,734) ndërsa llogaria 470 “*Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë*” është nënvlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë që është shtesa e debitorëve për vitin 2024.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese pika 7 germa c “*Për konstatimin paraprak të te drejtave për tu arkëtuar debitohehen llogaritë e klasës e klasës 4 (411-468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”. Në fund të vitit për debitorët e paarkëtuar, pjesa e buxhetit bëhet veprimi:*

- *Debithohet llogaria 8424, “Transferim për debitorë të konstatuar”;*
- *Kreditohet llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”.*

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..*

• **Paraqitja e Aktiveve neto dhe fondit të konsoliduar.**

- **Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”** në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën 2,422,490,383 ndërsa në fund të vitit 2024 , gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,388,566,970 lekë. Analiza e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*” paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.18: Lëvizja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*” viti 2024.

**Lekë**

Fondi i konsoliduar	Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”	
	Mbyllje më datë 31.12.2024	Çelje më datë 01.01.2024
2,388,566,970	Debi	Kredi
	Amortizimi i paksimit sipas pasqyrës nr. 7/b	Çelja gjendja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” i datës 31.12.2023
		2,422,490,383

	115,992	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	111,981,076	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	147,922,604	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	2,134,106	Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”
Totali	148,038,596		2,536,605,565	
2,536,605,565-148,038,596=2,388,566,970				
2,388,566,970-2,388,566,970 = 0				

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Çelja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,422,490,383 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet 2,388,566,970 lekë. Llogaria kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*” në vlerën 111,981,076 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 2,134,106 lekë sipas llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit*”.

Llogaria 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 115,992 lekë, amortizimin shtesë të vitit 2024 në vlerën 147,992,604 lekë.

Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” në fund të vitit 2024 dhe është paraqitur saktë.

## TË ARDHURAT

### 1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “*Të ardhurat nga taksat e tatimet*”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 16,288,990 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 17,098,111 lekë ose me një shtim në vlerën 809,121 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.19: Të dhëna për Llogarinë 70 “*Të ardhurat nga taksat e tatimet*”

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	17,098,111	16,288,990
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	40,139	98,116
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	-	-
7001	Tatim mbi Fitimin	40,139	98,116
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	-	-
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat	-	-
702	2.Tatimi mbi Pasurine	7,319,746	7,179,756
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	7,319,746	7,179,756
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe	-	-
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	-	-
703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	9,727,186	9,011,118
7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)	-	-
7031	Akciza	-	-
7032	Takse mbi sherbimet specifike	-	-
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	-	-
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	9,727,186	9,011,118
704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	-	-
7040	Takse doganore per mallrat e importit	-	-
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit	-	-
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte	-	-
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare	-	-

705	5.Takse e rruges	-	-
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare	-	-
709	7.Gjoha e Kamat vonesa	11,040	-

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

## 2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 32,529,716 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 35,913,06 lekë ose me një shtim në vlerën 3,383,350 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.20: Të dhëna për Llogarinë 71 “Të ardhura jo tatimore”.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	35,913,066	32,529,716
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	13,184,128	9,506,304
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare	0	0
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	13,184,128	9,506,304
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	22,728,938	23,023,412
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	22,728,938	23,023,412
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	0	0
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale	0	0
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	0	0
7114	Te ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	0	0
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje	0	0
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	0	0

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

## 3. Grante korente:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 482,719,803 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 507,830,880 lekë ose me një shtim në vlerën 25,111,077 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.21: Llogaria 72 “Grante korente”.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
72	V.GRANTE KORENTE	507,830,880	482,719,803
720	1.Grant korent I Brendshem	507,041,887	476,914,365
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	134,705,206	134,907,048
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	339,553,565	307,878,876
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti per mbulim deficitit(ISSH E ISKSH)	0	0
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	5,224,786	4,708,255
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit	25,638,166	29,420,186
7206	Financim I pritshe nga buxheti	1,920,164	0
7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	0	0
7209	Te tjera grante korente te brendshme	0	0
721	2.Grant korent I Huaj	788,993	5,805,438
	Nga Qeveri te Huaja	788,993	5,805,438
	Nga Organizata Nderkombetare	0	0

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

## Analiza e llogarive të të ardhurave.

Për vitin 2024, të ardhurat të paraqitura në pasqyrën e konsoliduar janë në total janë në vlerën 558,707,951 lekë.

Auditimi në lidhje me të ardhurat tatimore u fokusua në drejtim të rakordimit të të ardhurave sipas llojeve të tyre midis thesarit sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. U kryen rakordimet e të ardhurave me thesarin sipas llojeve të tyre dhe pasqyrimi i tyre në pasqyrën e performancës financiare të Bashkisë Skrapar në pasqyrat financiare të konsoliduar.

Nga auditimi i ushtruar për të dhënat e të ardhurave sipas kodit të të ardhurave për taksat dhe tarifave vendore dhe të ardhurave jo tatimore sipas thesarit me të ardhurat e raportuara në pasqyrën e performancës financiare u konstatua që të ardhurat në total sipas rakordimit të thesarit janë në vlerën prej 63,906,929 lekë për taksat dhe tarifave vendore si dhe të ardhurat nga pjesëmarrja në taksat nacionale. Në pasqyrën e pozicionit financiar, të ardhurat janë paraqitur në vlerën 58,235,963 lekë ose 5,670,996 lekë më pak. Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nga ana e saj ka pasqyruar të dhënat në lidhje me taksat dhe tarifave vendore dhe të ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përputhen me të dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse si më poshtë vijon:

Tabela nr.22: Krahasimi i te ardhurave taksa tarifa vendore pasqyra financiare /thesar

Lekë

Analiza	Lloji taksës arkëtuar ne llogarinë e Thesarit	Totali leke	Pasqyrat P/Financiare	Diferenca
c	d			
7002200	Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin	40,139		
700		40,139	40,139	0
7020100	Tatim mbi token Bujqësore	3,929,347		
7020200	Tatim mbi Ndërtesat	3,347,913		
7029200	Taks për kalimin e te drejtës Pron.P.Palujtesh.	42,486		
702		7,319,746	7,319,746	0
7035001	Taks vendore për regjistrim biznesi	52,800		
7035002	Taks për Zënie Hapësira Publike	499,800		
7035003	Taks ndikimi ne infrastrukture	262,477		
7035005	Taks Fjetje ne Hotel	30,100		
7035009	Taks Tabele	169,450		
7035011	Taks për shfrytëzimin e lendes Drusore	3,028,700		
7035013	Takse e Gjelbërit	1,300,008		
7035023	Taks Vendore Ndriçimi	2,182,420		
7035025	Taks vendore për truallin	472,131		
7035029	Tarife vendore për urbanistiken	15,000		
7035032	tarife Vendore për Shqyrtim Leje Zhvillimi	28,000		
7035033	Taks Vendore për lëshim Vërtetimi	84,300		
7035039	Taks vendore Leje shfrytëzimi Karburanti	1,000,000		
7035040	tarifë Vendore për leje ndërtimi	106,000		
7035045	tarifë Vendore për Varrezat	496,000		
703		9,727,186	9,727,186	0
7090103	Kamatëvonesa	11,040		
709		11,040	11,040	0
7109100	Te ardhura nga qira për token bujqësore	20,000		
7109200	Te ardhura nga qarat për Troje	2,308,500		
7109600	Te ardhura nga qerat per ndërtesat	194,400		
7109900	Te tjera te ardhura nga ndermarrja dhe pronesia	10,661,228		
710		13,184,128	13,184,128	0
7110105	Te tjera tarifa administrative	12,150		
7110106	Tarifa per leje transporti	20,169		
7110199	Te tjera tarifa administr.Rregull.Nacionale	691,079		
7110500	Te tjera tarifa administrative rregullatore te Nj.Q.V	38,550		
7110501	Tarif Pastrimi dhe Higjene	13,422,264		
7110599	Te tjera tarifa admin.rregull.njesive vendore	5,742,219		
7111001	Te ardhura nga Kopshtet e femijeve	556,160		
7111002	Te ardhura nga Çerdhet	579,900		

7111003	Te ardhura nga Qendra e Formimit Profes,	338,540		
7111007	Te ardhura nga Parkingu	214,600		
7113001	Tarifa nga bimet medicinale	30,700		
7113009	Te ardhura nga miratim projekt MNZ	45,000		
7115499	Te tjera gjoba	64,000		
7115500	Kamat Vonesa	84,562		
7115600	Sekuestrime dhe shdetime	889,045		
711		22,728,938	22,728,938	0
7201101	Te ardhura nga DRSHTR (7033016)	5,670,966	0	5,670,966
7204102	Tatim nga te ardhurat Personale( 2%)	5,224,786	5,224,786	0
720		10,895,752		
		63,906,929	58,235,963	5,670,966

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit

**Konkluzion:** Nga auditimi u konstatua që ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre e cila vjen si pasojë e mos administrimit të saktë të llojeve të detyrimeve tatimore sipas llojit të tyre. Konstatohen pasaktësi në pasqyrimin e taksave dhe tarifave vendore nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit pasi ka paraqitur në pasqyrën e performancës financiare të ardhura në vlerën 5,670,966 lekë nga taksat dhe tarifave vendore dhe të ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përpunohen me të dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse të të ardhurave. Vlera prej 5,670,966 lekë nuk është paraqitur si zë më vete por është pasqyruar te grande llogaria 720.

Nga verifikimi i kryer në lidhje me pasqyrimin e të dhënave në pasqyrën Cash Flow Formati nr.1 i pasqyrave financiare të konsoliduar u konstatua që fonde të përdorura gjatë vitit 2024 në funksion të shpenzimeve korente dhe investimeve janë në total 727,457,639 lekë të detajuara si më poshtë vijon:

Tabela nr.23: Të dhëna për fondet sipas Cash Flow/përdorim fondesh.

Lekë

Emërtimi i institucionit	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+)	Arkëtime e te hyra(Cash), gjatë vitit ushtrimor	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)	Totali I fondeve akorduara sipas cash floë	Kthim ne buxhet I fondeve te pa përdorura	Total fonde ne dispozicion
	1	2	3	4=1+2+3	5	6=4-5
Bashkia Qendër Skrapar	417,206,224	68,608,126	123,627,627	609,441,977	4,193,065	605,248,912
Ndërmarrja e shërbimeve publike	104,117,221	0	201,762	104,318,983		104,318,983
Ndërmarrja e shërbimit pyjor	17,889,744			17,889,744		17,889,744
Bilanci i konsoliduar Bashkia Skrapar	539,213,189	68,608,126	123,829,389	731,650,704	4,193,065	727,457,639

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Nga auditimi u konstatua që arkëtime të hyra Cash gjatë vitit nuk janë në vlerën 68,608,126 lekë por sipas akt rakordimit me thesarin janë në vlerën 64,695,922 lekë nga të cilat të hyra nga taksat dhe tarifave vendore dhe pjesëmarrje në taksa nacionale janë në vlerën 63,906,929 lekë, ndërsa 788,993 lekë janë rimbursim shpenzimesh pas performancës Kendi sportiv të cilat janë regjistruar si grand korent i huaj llogaria 721 në pasqyrat e performancës financiare të konsoliduar. Për sa më sipër Arkëtime të hyra(Cash), gjatë vitit ushtrimor janë në vlerën 3,912,204 lekë më pak (68,608,126-64,695,922) nga të cilat fondet në vlerën 3,123,211 lekë (3,912,204-788,993) më pak fonde të përdorura në funksion të shpenzimeve korente dhe investimeve. Sipas pasqyrës së Cash flou total fonde në dispozicion janë 727,457,639 lekë dhe sipas përlllogaritjeve janë në vlerën 724,334,428 lekë (727,457,639-3,123,211 ). Nga auditimi i të dhënave të akt rakordimeve për të ardhurat e trashëguara u konstatua që të ardhura të trashëguara për vitin 2025 janë në vlerën 59,976,260 lekë. Grupi i auditimit kreu përlllogaritjet në lidhje me të ardhurat që duheshin pasqyruar në pasqyrën e performances financiare të konsoliduar duke i krahasuar me të ardhurat e pasqyruara në pasqyrën e performances së konsoliduar. Të dhëna në lidhje me përlllogaritjet janë si më poshtë vijon:

Tabela nr.24: Përlllogaritja e të ardhurave.

Nr.	Emërtimi	Vlera/lekë
1	Fonde në dispozicion	724,334,428
2	Të ardhura që trashëgohen në vitin 2025	59,976,260
3	Pagesa për investime llogaria 230-231	111,981,080
4=1-2-3	Të ardhura që duheshin pasqyruar në PPF	552,377,088
5	Pasqyruar në pasqyrat financiare	558,707,951
6=5-4	Diferenca	6,330,863

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

**Konkluzion:** Nga auditimi i pasqyrimin të të ardhurave në pasqyrën e performances financiare u konstatua që janë pasqyruar të ardhura në vlerën 558,707,951 lekë dhe duhej te pasqyroheshin në vlerën 552,377,088 lekë ose janë pasqyruar 6,330,863 lekë më shumë.

Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 4 pika 7. “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar”.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë e pika 1. “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi”: Pika 1.3. “Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve” germa ç).

Veprime në kundërshtim me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”.

Sipas Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, me termin “Shpenzim” kuptojmë pakësimin e pasurisë neto, e cila përfundon me kryerjen e pagesave kapitale ose korrente, të pakthyeshme, me ose pa detyrim kthimi. Ndërsa me termin “E ardhur” kuptojmë rritjen e pasurisë neto, e cila përfundon me arkëtime kapitale ose korrente, me ose pa detyrim kthimi.

Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me:

njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; si dhe njohjen e të ardhurave në çastin e arkëtimit të tyre”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..

- **Llogaria 73“Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve”**, në datën në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie është pasqyruar në vlerën -2,134,106 lekë.

Nga auditimi i kryer në lidhje me këtë llogari u konstatua se, në pasqyrat financiare të konsoliduar formati nr.2 Pasqyra e Performancës Financiare është pasqyruar llog. 73“Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve” në vlerën -2,134,106 lekë. Kjo vlerë ka dhënë efekt në uljen e të ardhurave të vitit ushtrimor 2024 duke ndikuar në rezultatin financiar.

Për sa më sipër llogaria. 73“Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve” në vlerën -2,134,106 lekë është paraqitur gabim në pasqyrat financiare të konsoliduar, pasi vlera e kësaj llogarie duhet të ishte paraqitur zero lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së

përgjithshme”, 2.1 Parimet e kontabilitetit në sektorin publik.

## **SHPENZIMET**

### **1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore.**

Llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*” në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 221,488,665 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 248,713,868 lekë ose me një rritje në vlerën 27,225,203 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Skrapar me të njëjtën vlerë.

-Llogaria 601 “*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*”, në datën 31.12.2023-, ka qenë në vlerën 36,312,179 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 41,672,619 lekë ose me një rritje në vlerën 5,360,440 lekë. Analiza për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.25: Të dhëna për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësorë.

		<b>Lekë</b>	
<b>Llogaria</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2024</b>	<b>31.12.2023</b>
6001	Paga, personel I përhershëm	247,365,268	217,771,128
6002	Paga personel I Përkohshëm	1,348,600	3,717,537
6003	Shpërblime	0	0
6009	Shpenzime te tjera për personelin	0	0
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	37,461,668	32,679,540
6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	4,210,951	3,632,639

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

### **2. Blerje mallra dhe shërbime.**

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “*Blerje mallra dhe shërbime*”, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 75,581,781 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 78,785,490 lekë ose me një rritje në vlerën 3,203,709 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Skrapar me të njëjtën vlerë. Analiza e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.26: Të dhëna për llogarinë 602 “*Blerje mallra dhe shërbime*”.

		<b>Lekë</b>	
<b>Llogaria</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2024</b>	<b>31.12.2023</b>
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	78,785,490	75,581,781
602	Mallra dhe shërbime te tjera	0	0
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	5,106,164	9,180,426
6021	Materiale dhe shërbime speciale	3,791,903	2,800,646
6022	Shërbime nga te trete	12,197,809	15,450,453
6023	Shpenzime transporti	20,313,285	19,868,149
6024	Shpenzime udhetimi	4,410,068	3,739,140
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	7,632,288	4,693,030
6026	Shpenzime per qeramarrje	509,200	691,000
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	4,161,958	8,229,807
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	1,135,767	435,099
6029	Shpenzime te tjera operative	19,527,048	10,494,031

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

Llogaria sintetike 602 “*Blerje mallra dhe shërbime*”, paraqitet në vlerën 78,785,490 lekë dhe përfaqëson vlerën e të gjitha shpenzimeve operative gjatë vitit 2024 përkatësisht si vijon:

- Gjendja e llogarisë analitike 6020 “*Materiale zyre e të përgjithshme*” në vlerën 5,106,164 lekë përfshin, blerje materiale kancelarie, blerje dokumentacioni, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës, materiale për pastrim, dezinfektim, furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme.
- Gjendja e llogarisë analitike 6021 “*Materiale dhe shërbime speciale*” në vlerën 3,791,903 lekë përfshin, blerje uniforma dhe veshje, shpenzime për furnizim me ushqime për kopshtet dhe çerdhet, etj..
- Gjendja e llogarisë analitike 6022 “*Shërbime nga të tretët*” në vlerën 12,197,809 lekë përfshin, shpenzime elektriciteti, uji, shërbime postare, telefoni, shpenzime për ngrohje, etj..
- Gjendja e llogarisë analitike 6023 “*Shpenzime transporti*” në vlerën 20,313,285 lekë përfshin, shpenzime Karburant dhe vaj, pjesë këmbimi & goma, shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit, shpenzime të tjera transporti.
- Gjendja e llogarisë analitike 6024 “*Shpenzime udhëtimi*” në vlerën 4,410,068 lekë përfshin, shpenzime udhëtim për brenda dhe jashtë vendit.
- Gjendja e llogarisë analitike 6025 “*Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme*” në vlerën 7,632,288 lekë përfshin, shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave, shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, rrjeteve hidraulike, elektrike, etj..
- Gjendja e llogarisë analitike 6026 “*Shpenzime për qiramarrje*” në vlerën 509,200 lekë përfshin, shpenzime për qiramarrje ambientesh.
- Gjendja e llogarisë analitike 6027 “*Shpenzime për detyrime për kompensime legale*” në vlerën 4,161,958 lekë përfshin, shpenzime për ekzekutim vendime gjyqësore dhe detyrimet përmbartimore të paguara.
- Gjendja e llogarisë analitike 6028 “*Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua*” në vlerën 1,135,767 lekë përfshin, shpenzime për bursa të konviktorëve përfitues.
- Gjendja e llogarisë analitike 6029 “*Shpenzime të tjera operative*” në vlerën 19,527,048 lekë përfshin, shpenzime për pritje e përcjellje, shpenzime për aktivitete sociale, etj.

### 3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Skrapar nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024.

### 4. Transferime korente:

Gjendja e llogarive të fondeve të transferimeve korente paraqitet në bilanc si në tabelën në vijim.

Tabela nr.27: Të dhëna për llogarite 604,605,606.

Llogaria	Emërtimi	Lekë	
		31.12.2024	31.12.2023
604	1.Transferime korente të brendshme	131,139,002	128,808,869
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë	2,882,652	3,822,059
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	-	-
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore	-	-
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	128,256,350	124,986,810
605	2.Transferime korente me jashtë	-	-
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	-	-
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja	-	-
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse të huaja	-	-
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit	-	-

606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	393,908	150,650
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	-	-
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	393,908	150,650

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

- **Llogaria 604 “Transferime korrente të brendshme”**, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 128,808,869 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 131,139,002 lekë ose me një rritje në vlerën 2,330,133 lekë.

- **Llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”**, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 150,650 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 393,908 lekë ose me një rritje në vlerën 243,258 lekë.

**5. Llogaria 63 “Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit”**, në datën në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie është pasqyruar në vlerën -2,134,106 lekë.

**6. Llogaria “Shpenzime të Tjera”**, në datën në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie është pasqyruar në vlerën 160,910 lekë.

Nga auditimi i kryer në lidhje me kontabilizimet e llogarive kontabël u konstatua që Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk mban të dhëna në kontabilitet në lidhje me detyrimet e konstatuara sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara por regjistrimet në kontabilitet i kryen në bazë të likuidimit të tyre.

Nga auditimi i pasqyrës se performances financiare u konstatua që llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*” është regjistruar në këto pasqyra në vlerën prej 248,713,868 lekë. Vlera e likuiduar në thesar gjatë vitit 2024 për ketë llogari është 247,077,390 lekë. Likuidimet në thesar gjatë vitit 2024 përfshijnë pagesat e kryera për pagat e muajit Dhjetor 2023 të likuiduara në Janar 2024 dhe nuk përfshijnë pagat e muajit Dhjetor 2024 që likuidohen në Janar 2025. Grupi i auditimit kreu përlllogaritjet e pasqyrimin të llogarisë 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*” si më poshtë vijon:

Tabela nr.28: Përlllogaritjet në lidhje me pasqyrimin e llogarisë 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*”

Nr.	Llogaria	Përshkrimi	Vlera /lekë
1	600	Fakti thesar Bashkia Total	247,077,390
2	42	Detyrime ndaj personelit fund 2024 PF (thesar)	20,338,947
3	42	Detyrime ndaj personelit fund 2023 PF	17,097,165
4=2-1	42	# I gjendjes I llogarisë (2024-2023)	3,241,782
5	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa Fund 2024	1,748,683
6	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa Fund 2023	792,134
7=5-6	431	# I gjendjes llogarisë (2024-2023)	956,549
8=1+4+7	600	Duhej pasqyruar ne PF	251,275,721
9	600	Pasqyruar ne Pasqyra P/financiare	248,713,868
10=8-9	600	Pasqyruar me pak ne PP financiare	2,561,853

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Për të saktësuar paraqitjen e llogarisë 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*” u verifikuan gjendjet e llogarisë 42 “*Detyrime ndaj personelit*” në fund të vitit 2024 dhe në fund të vitit 2023 dhe të llogarisë 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*”. Në fund të vitit 2024 vlera e llogarisë 42 “*Detyrime ndaj personelit*” është 20,338,947 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 është në vlerën 17,097,165 lekë. Shtesa e llogarisë 42 “*Detyrimeve për personelin*” për vitin 2024 është 3,241,782 lekë. Llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 1,748,683 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 792,134 lekë. Shtesa e llogarisë 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim*”

taksa” për vitin 2024 është në vlerën 956,549 lekë. Faktit në thesar të llogarisë 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” i shtohen shtesat e llogarisë 42 “Detyrimeve për personelin” dhe shtesat e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për të saktësuar gjendjen e llogarisë 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në pasqyrat e performancës financiare që rezulton në vlerën 251,275,721 lekë (247,077,390+3,241,782+ 956,549 ).

Nga auditimi u konstatua që në pasqyrat e performancës financiare llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” është pasqyruar 248,713,868 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 251,75,721 lekë ose është pasqyruar 2,561,853 lekë më pak.

• **Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Skrapar).**

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar, Maj dhe Dhjetor 2024) dhe konstatohet se ato plotësohen sipas rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore. Është hartuar përmbledhësja në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Skrapar, janë në përputhshmëri me kërkesat e Ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Skrapar, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 44/1, datë 29.03.2024, i ndryshuar.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar, Maj dhe Dhjetor 2024) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës z. N. G. dhe nga Kryetari Bashkisë z. A. M..

Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që llogaria 601 “Kontributet e sigurimeve” është regjistruar në këto pasqyra në vlerën prej 41,672,619 lekë. Vlera e likuiduar në thesar gjatë vitit 2024 për këtë llogari është 41,401,190 lekë. Likuidimet në thesar gjatë vitit 2024 përfshijnë pagesat e kryera për kontributet e sigurimeve të muajit Dhjetor 2023 të likuiduara në Janar 2024 dhe nuk përfshijnë kontributet e sigurimeve të muajit Dhjetor 2024 që likuidohen në Janar 2025. Grupi i auditimit kreu përlllogaritjet e pasqyrimit të llogarisë 601 “Kontributet e sigurimeve shoqërore” si më poshtë vijon:

Tabela nr.29: Përlllogaritjet në lidhje me pasqyrimin e llogarisë 601 “Kontributet e sigurimeve shoqërore”

Nr.	Llogaria	Pershkrimi	Vlera /lekë
1	601	Fakti thesar Bashkia Total	41,401,190
2	435-436	Detyrime për sigurime fund 2024 sipas Pasqyrës se pozicionit financiar(PPF)	6,135,339
3	435-436	Detyrime për sigurimin fund 2023 sipas Pasqyrës se pozicionit financiar(PPF)	4,803,702
4=2-3	435-436	# I gjendjes I llogarisë (2024-2023)	1,331,637
5=1+4	601	Duhej pasqyruar ne Pasqyrën e Performances Financiare	42,732,827
6	601	Pasqyruar ne Pasqyra Pasqyrën e Performances Financiare	41,672,619
7=5-6	600	Pasqyruar me pak ne Pasqyrën e Performances Financiare	1,060,208

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Për të saktësuar paraqitjen e llogarisë 601 “Kontributet e sigurimeve shoqërore” u verifikuan gjendjet e llogarisë 435-436 “Detyrime për sigurime” në fund të vitit 2024 dhe në fund të vitit 2023.

Në fund të vitit 2024 vlera e llogarisë 435-436 “Detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore” është

6,135,339 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 është në vlerën 4,803,702 lekë. Shtesa e llogarisë 435-436 “Detyrime për sigurime” për vitin 2024 është 1,331,637 lekë. Faktit në thesar të llogarisë 435-436 “Detyrime për sigurime” i shtohen shtesat e llogarisë 435-436 “Detyrime për sigurime” për të saktësuar gjendjen e llogarisë 435-436 “Detyrime për sigurime” në pasqyrat e performancës financiare që rezulton 42,732,827 lekë (41,401,190+1,331,637 ). Nga auditimi u konstatua që në pasqyrat e performancës financiare llogaria 435-436 “Detyrime për sigurime” është pasqyruar 41,672,619 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 42,732,827 lekë ose është pasqyruar 1,060,208 lekë më pak.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime” është regjistruar në këto pasqyra në vlerën prej 78,785,490 lekë. Vlera e likuiduar në thesar gjatë vitit 2024 për këtë llogari është 78,773,230 lekë. Likuidimet në thesar gjatë vitit 2024 përfshijnë pagesat e kryera për “Furnitorë e llogari të lidhura me to” të vitit 2023 të likuiduara në vitin 2024 dhe nuk përfshijnë “Furnitorë e llogari të lidhura me to” të konstatuara në vitin 2024 që likuidohen në vitin 2025. Grupi i auditimit kreu përlllogaritjet e pasqyrimin të llogarisë 602 “Blerje mallra dhe shërbime” si më poshtë vijon:

Tabela nr.30: Përlllogaritjet e pasqyrimin të llogarisë 602 “Blerje mallra dhe shërbime”.

Nr.	Llogaria	Pershkrimi	Vlera/lekë
1	602	Blerje mallra dhe shërbime Fakti thesar Bashkia Total	78,773,230
2	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to fund 2024	4,316,066
3	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to fund 2023	1,611,307
4=2-3	401-408	# Furnitorë e llogari te lidhura me to	2,704,759
5=1+4	602	Blerje mallra dhe shërbime duhet pasqyruar fund 2024	81,477,989
6	602	Blerje mallra dhe shërbime Bashkia Total pasqyruar	78,785,490
7=5-6	602	Blerje mallra dhe shërbime Bashkia Total pasqyruar me pak ne PF	2,692,499

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/përpunoi grupi i auditimit.

Për të saktësuar paraqitjen e llogarisë 602 “Blerje mallra dhe shërbime” u verifikuan gjendjet e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në fund të vitit 2024 dhe në fund të vitit 2023. Vlera e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në fund të vitit 2024 është 4,316,066 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 është në vlerën 1,611,307 lekë. Shtesa e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” për vitin 2024 është 2,704,759 lekë. Faktit në thesar të llogarisë 602 “Blerje mallra dhe shërbime” i shtohen shtesat e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për të saktësuar gjendjen e llogarisë 602 “Blerje mallra dhe shërbime” në pasqyrat e performancës financiare që rezulton në vlerën 81,477,989 lekë (78,773,230+2,704,759 ). Nga auditimi u konstatua që në pasqyrat e performancës financiare llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime” është pasqyruar 78,785,490 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 81,477,989 lekë ose është pasqyruar 2,692,499 lekë më pak.

**Konkluzion:** Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” është pasqyruar në vlerën 248,713,868 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 251,275,721 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 2,561,853 lekë.

- Llogaria 435-436 “Detyrime për sigurime” është pasqyruar 41,672,619 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 42,732,827 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 1,060,208 lekë.

- Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime” është pasqyruar 78,785,490 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 81,477,989 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 2,692,499 lekë.

Nga tërësia e të dhënave të mësipërme janë pasqyruar më pak në pasqyrat e performancës financiare shpenzime për shumën 6,314,560 lekë (2,561,853+1,060,208+2,692,499).

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 3.2 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 5 “Llogaritë financiare” Në tërë funksionimin e llogarive mbahet parasysh aplikimi i një nga bazave kryesore të kontabilitetit publik “Detyrimet dhe të drejtat e konstatuara”, që do të thotë:

Institucionit për çdo shpenzim që do të kryejë i lind një detyrim. Pra, duhet të nxirret një urdhër i justifikuar. Ky quhet shpenzim dhe duhet kontabilizuar.

Për çdo të ardhur që do të realizojë, institucioni konstaton një të drejtë dhe merr një angazhim për ta arkëtuar. Pra, nxirret një titull. Kjo quhet e ardhur dhe duhet kontabilizuar.

Si rregull i përgjithshëm, në kuadrin e zbatimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara, llogaritë e disponibiliteteve debitoohen ose kreditohen në bazë të dokumentave që vërtetojnë ekzekutimin e angazhimeve të marra (arkëtim titulli të ardhurash, pagesë, detyrimi për shpenzimet në bazë të urdhrit të shpenzimit).

Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që llogaria 604 “Transferime korente të brendshme” është pasqyruar në pasqyrat e konsoliduar në vlerën 131,139,002 lekë ndërkohe që sipas thesarit është 2,882,652 lekë ose pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare 128,256,350 lekë.

Tabela nr.31: Krahasimi i llogarisë 604 “Transferime korente të brendshme” me të dhënat e thesarit.

Nr.	Llogaria	Pershkrimi	Vlera /lekë
1	604	Transferime korente te brendshme Thesar	2,882,652
2	604	Transferime korente te brendshme PF	131,139,002
3=2-1	604	Transferime korente te brendshme pasqyruar me shume ne PF	128,256,350

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” është pasqyruar në pasqyrat e konsoliduar në vlerën 393,908 lekë ndërkohe që sipas thesarit është në vlerën 128,650,258 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare në vlerën 128,256,350 lekë.

Tabela nr.32: Krahasimi i llogarisë “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” me të dhënat e thesarit.

Nr.	Llogaria	Pershkrimi	Vlera/lekë
1	606	Transferime për Buxhetet familjare e Individë Thesar	128,650,258
2	606	Transferime për Buxhetet familjare e Individë PF	393,908
3=1-2	606	Pasqyruar me pak ne PF	128,256,350

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar.

Nga auditimi konstatohet që është pasqyruar në pasqyrat e performancës llogaria 604 “Transferime korente të brendshme” më shumë për vlerën 128,650,258 lekë dhe llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” më pak për vlerën 128,650,258 lekë. Llogaria 604 “Transferime korente të brendshme” duhej të pasqyrohej në vlerën 2,882,652 lekë ndërsa llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjar e Individë” duhej të pasqyrohej në vlerën 128,650,258 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme: nënpika 28, 29 “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet më vete), para evidentimit të të dhënave në pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore.

*Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese.”*

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave z. N. G..*

Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve të Bashkisë Skrapar në nën llogarinë 627400, u konstatua që përgjatë vitit 2024 bashkia ka kryer likuidime në vlerën 2,695,558 lekë për shpenzime gjyqësore dhe shpenzime përmbartimore në 8(tetë) urdhër shpenzime duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit dhe shpenzime pa ekonomikitet në vlerën 2,695,558 lekë. Urdhër shpenzimet paraqiten të detajuara në aneksin 1/32, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhet. Vlera prej 2.695,558 lekë shpenzime gjyqësore dhe shpenzime përmbartimore sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit dhe janë shpenzime pa ekonomikitet.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:*

*z. A. M. Kryetari i Bashkisë nëpunës autorizues.*

*z. N. G. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/Nëpunës zbatues.*

#### ● **Rezultati i veprimtarisë për vitin 2024.**

Për vitin 2024, totali i të ardhurave sipas pasqyrave financiare të konsoliduar është në vlerën 558,707,951 lekë dhe totali shpenzimeve është 498,731,691 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 59,976,260 lekë pasqyron në pasqyrën e performancës financiare(Formati Nr.2) gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor”.

Nga analiza e kryer më sipër në kapitujt përkatës të të ardhurave dhe shpenzimeve u konstatua se:

1- Totali i të ardhurave është reduktuar me vlerën e Llogarisë 73 “Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve” në vlerën 2,134,106 lekë, kur ky veprim është bërë në llogarinë 63 “Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit”, për rrjedhojë është dhënë efekti i përsëritur në llogaritjen e rezultatit të veprimtarisë ekonomike. Ky veprim ka sjellë uljen e rezultatit të veprimtarisë së vitit ushtrimor në vlerën 2,134,106 lekë. Për rrjedhojë rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor që duhet të pasqyrohet në pasqyrën e performancës financiare(Formati Nr.2) llogaria 85“Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” duhet të jetë 62,110,366 lekë (558,707,951+2,134,106-498,731,691).

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, 2.1 Parimet e kontabilitetit në sektorin publik.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: z. N. G. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave/Nëpunës zbatues.*

• **Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës:

Nga verifikimi me zgjedhje i periudhave Janar, Maj, Dhjetor 2024 në lidhje me transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës konstatohet se: Transaksionet janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet arkës:

Nga verifikimi me zgjedhje i periudhave Janar, Maj, Dhjetor 2024 në lidhje me veprimet me arkë konstatohet se:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet arkës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e arkës në bazë të arkëtimeve dhe pagesave të kryera nga Bashkia Skrapar. Çdo ditë janë derdhur në bankë nga znj. Ad. Xh. të ardhurat e arkëtuara në arkë. Për arkëtimet dhe pagesat është mbajtur libri dhe ditari i arkës.

Për periudhën e përzgjedhur për auditim rezulton se; për muajin Janar në 250 raste

arkëtimet në arkë janë në vlera të mëdha se 1,000 lekë; për muajin Maj në 145 raste arkëtimet në arkë janë në vlera të mëdha se 1,000 lekë dhe për muajin Dhjetor 2024 në 215 raste arkëtimet në arkë janë në vlera të mëdha se 1,000 lekë. Arkëtimet e kryera janë kryesisht arkëtime të taksave nga ana e taksa paguesve të Bashkisë Skrapar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 64 ku citohet;

64. Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë.

Dokumentet e përdorura për arkëtime(mandat arkëtime) janë pa numër serial dhe në disa raste të firmosura nga arkëtarit dhe personi që ka bërë arkëtimin. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 68, ku citohet se;

68. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtëshënuar:

a) Mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjësi që kryen derdhjen dhe nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

b) Mandatpagesa nënshkruhet nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare.

c) Nëpunësi autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhëruar të nënshkruar prej tij.

Nga verifikimi i fletëhyrjeve në magazinë dhe konkretisht fletëhyrjes me nr. 46, datë 20.12.2024 rezulton se, furnizimin me dokumente të përdorura për arkëtime dhe pagesa(mandat arkëtime dhe mandat pagesa), Bashkia Skrapar e ka bërë nga persona të rastësishëm dhe jo nga shtypshkronja e letrave me vlerë. Mandat arkëtimet e përdorura nuk kanë numër serie të para shtypur. Përdorimi i këtyre

dokumenteve që nuk përmbushin standartet ligjore për përdorim në sektorin publik ka riskë të lartë që ka të bëjë me ruajtjen e gjurmës së auditimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 6/ç, 12/dh dhe Vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar, pika 1 dhe pika 2.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar znj. T. Sh..*

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në lidhje me procedurën e vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit në Njësinë Shpenzuese të Ndërmarrjes së Shërbimit Publik u konstatua se në të njëjtën ditë ka dalë urdhri për ngritjen e komisionit dhe në të njëjtën ditë është mbajtur proces verbali për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit dhe në të njëjtën ditë është mbajtur proces verbali për asgjësimin e tyre. Proces verbalet për vlerësimin dhe asgjësimin kanë të dhëna të pasakta në lidhje me llojin e mallrave, gjendjen, natyrën e tyre, sasinë dhe çmimin dhe përmbajnë 56 artikuj në vlerën 1,735,741 lekë. Në Pasqyrat financiare për nxjerrjen jashtë përdorimit është reflektuar vlera prej 115,992 lekë që i përket llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, ndërsa diferenca prej 1,619,749 lekë (1,735,741-115,992) nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave është lenë gjendje inventari, nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare si nxjerrje jashtë përdorimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 8, germa (ç) dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 95, pika 106 dhe pika 114.

*(Më hollësisht trajtuar në nënkapitullin III.2, faqe 16-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për saktësimin e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave në Njësinë Shpenzuese të Ndërmarrjes së Shërbimit Publik për vlerën 1,619,749 leke, duke ngritur komision të posaçëm të vlerësimit dhe asgjësimit, si dhe duke përfshirë kontrollin fizik e financiar të aktiveve si dhe të informojë Këshillin Bashkiak për efektet ekonomike dhe vendimet për nxjerrje jashtë përdorimit.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Skrapar, mbahet në mënyrë manuale duke përdorur programi Excel, e cila ka risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që gjenerohet nga ky sistemi për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të njësisë dhe njësive të vartësisë. Programi Excel nuk përbën një “bartës informatik” të specializuar, i cili të garantojë mosmanipulimin e të dhënave, si dhe mundësinë e gjenerimit dhe printimit të informacionit në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mos besueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekte. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e

programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare si dhe në ruajtjen e gjurmës së auditimit, Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6/d, neni 12/dh. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që mbajtja e kontabilitetit në Bashkinë Skrapar dhe njësite e varësisë të kryhet nëpërmjet programeve financiare të autorizuara të pa manipulueshme në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare si dhe në ruajtjen e gjurmës së auditimit.

#### *Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua që llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar në vlerën 36,880,205 lekë ose 309,195 lekë më shumë se akt rakordimi me thesarin (36,880,205 - 36,571,010). Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk rakordon me të dhënat e thesarit për vlerën prej 309,195 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 3, nënpika 28, 29. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë llogarinë 466“Kreditorë për mjete në ruajtje” në pasqyrën e pozicionit financiar për diferencën e mbivlerësuar prej 309,195 lekë më shumë se akt rakordimi me thesarin dhe ta paraqesë sakte atë në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer mbi paraqitjen e saktë të llogarive kontabël të inventarëve në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar, u konstatua se Njësia Shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” ka kryer pasqyrim të gabuar të disa llogarive, konkretisht:

Në llogarinë 32 “Inventarë i imët” është paraqitur vlera 1,414,995 lekë, e cila duhej të pasqyrohej në llogarinë 31 “Materiale”; Në llogarinë 33 “Prodhim në proces” është paraqitur vlera 1,810,152 lekë, e cila duhej të pasqyrohej në llogarinë 32 “Inventarë i imët”.

Si rrjedhojë e këtyre pasqyrimeve të pasakta, llogaria 31 “Materiale” rezultoi e nënvlerësuar me 1,414,995 lekë; llogaria 33 “Prodhim në proces” rezultoi e mbivlerësuar me 1,810,152 lekë dhe llogaria 32 “Inventarë i imët” rezultoi e nënvlerësuar me 395,157 lekë (1,810,152 – 1,414,995). Këto pasqyrime të pasakta kanë sjellë paraqitje jo të drejtë të inventarëve në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, pika 3.1 dhe Kapitulli III. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, në bashkëpunim me Njësinë e Varësisë “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike”, të marrin masa për rishikimin e regjistrimeve kontabël dhe të bëjnë korigjimin e debive dhe kredive në llogaritë 31 “Materiale”, 32 “Inventarë i imët” dhe 33

“Prodhim në proces”, në mënyrë që saldoja e inventarëve të pasqyrohet saktë në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar.

### ***Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer mbi paraqitjen e drejtë të llogarive në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar, rezultoi se Njësia Shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” ka pasqyruar gabimisht vlerën 6,802,914 lekë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlerë e cila duhej të regjistrohej në llogarinë 4342 “Operacionet me shtetin të drejta”.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” e pasqyruar në fund të vitit 2024 në vlerën 26,036,121 lekë në pasqyrat financiare të konsoliduar është nënvlerësuar për vlerën 6,802,914 lekë dhe nuk kuadron me kundër partitë e saj që janë llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”, llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, llogaria 435 “Sigurime Shoqërore”, llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore”. Nga analiza e kryer rezultoi se Njësia Shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP) e ka paraqitur llogarinë 4342 “Operacione me shtetin të drejta” në fund të vitit 2024 në vlerën zero lekë kur kundër partitë e saj janë në vlerën 6,802,914 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa “dh”; me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39 si dhe Kapitulli III. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 21-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Njësinë Shpenzuese Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike të marrin masa që të pasqyrojnë saktë në pasqyrën e pozicionit financiar mospërputhjen për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila në krahasim me thesarin është mbivlerësuar në vlerën 6,802,914 lekë dhe llogarinë 4342 “Operacione me shtetin të drejta” e cila është nënvlerësuar për vlerën 6,802,914 lekë.

### ***Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pozicionit financiar të pasqyrave të konsoliduar u konstatua që gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 26,036,121 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 1,920,164 lekë. Diferenca prej 24,115,957 lekë (26,036,121 - 1,920,164) konstatohet në pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar (qendër).

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” duhej të paraqitej në vlerën 32,839,035 lekë (26,036,121 + 6,802,914). Vlera e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të jetë e barabartë me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 22-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë

llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është nënvlerësuar për vlerën prej 32,839,035 lekë që i korrespondon me kundër partinë e saj llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin të drejta”.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat analitike të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” rezultojnë 25 studime dhe projektme të pasqyruara në vlerën e tyre historike 106,814,857 lekë. Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se:

- Llogaria 230-231 “Investimet” është në vlerën zero lekë. Nga të dhënat e llogarisë 230-231 “Investime” në pasqyrën e pozicionit financiar nuk paraqitet asnjë objekt që të jetë në proces pasi kapitalizimi i aktiveve është bërë sipas likuidimeve pjesore vjetore dhe jo sipas përfundimit të objekteve dhe akteve të marrjes në dorëzim të tyre. Nga analiza e kryer rezultoi që në 31.12.2024 janë 8 objekte me vlerë 70,602,709 lekë, investime, për të cilat grupit të auditimit nuk ju paraqit certifikata e marrjes në dorëzim.

- Në përbërje të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” ka 6 projekte të cilat lidhen me ujësjellës me vlerë historike 78,985,358 lekë që duhet ti bashkëngjiten kapitalizmit të aktiveve dhe të transferohen në “Sh. R. U. K. B. Sha” me NIPT. M..O.

- Nga të dhënat e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” rezultoi se nuk ka informacion në lidhje me përfundimin e objekteve që u përkasin 13 projektet në vlerën 14,852,624 lekë.

Për sa më sipër kontabilizimit i pakësimit të llogarisë 230 - 231 “Investime në proces” nuk paraqet një pamje të drejte në shtesat e llogarive të aktiveve të qëndrueshme jo materiale dhe materiale përkatësisht llogaritë 202, 212, 213, 214.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitëve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Kreu, Aneksi 1 pika 2, klasa 2, pika 5 dhe pika 2.1.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 24-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë llogarinë 230-231 “Investime” në pasqyrën e pozicionit financiar për objektet që janë në proces dhe nuk kanë përfunduar dhe marrë në dorëzim.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**7.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” në pasqyrën e pozicionit financiar për 6 projekte të cilat lidhen me ujësjellës me vlerë historike 78,985,358 lekë që duhet ti bashkëngjiten kapitalizmit të aktiveve dhe të transferohen në “Sh. R. U. K. B. Sha” me NIPT M..O.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**7.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje me përfundimin e objekteve që u përkasin 13 projektet në vlerën 14,852,624 lekë për të cilat nuk ka informacion. Për objektet e përfunduara të marrë masa për kapitalizimin e tyre në shtesa të llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe në llogarisë

213 “*Rruge, rrjete, vepra ujore*” dhe llogarinë 214 “*Instalime teknike makineri e pajisje*”.

### *Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, u konstatua se, nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit;

a) trojet nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, dhe të zyrave në Njësive Administrative, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”.

b) trualli i godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojet të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 “*Toka, troje terrene*” rezultoi se kjo llogari nuk paraqet një pamje drejtë për pasqyrat financiare të vitit 2024, pasi kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 “*Toka, troje terrene*”, si dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare rezultojnë të paplota, për shkak të mungesës së analizave shoqëruese dhe detajuese.

Mungesa e analizimit të kësaj llogarie ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

(*Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 25-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të ngrenë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Skrapar të kaluar me VKM për llogarinë 210 “*Toka, troje terrene*”. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa për kontabilizimin e saktë të kësaj llogarie.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur u konstatua se në llogarinë. 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, është pasqyruar vetëm “*Pyllëzimi Kurorës së Qytetit të Çorovodës*” në vlerën 6,911,988 lekë. Bashkia Skrapar nuk ka bërë vlerësimin e pyjeve dhe kullotave të transferuara, për rrjedhojë dhe në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Skrapar, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban,

a) listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Skrapar, me numër rendor nga 1(një) deri 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy).

b) godinën e DSHP-së.

Për këto sipërfaqe nuk është bërë verifikimi fizik dhe vlerësimi i tyre, me qëllim përcaktimin e e saktë të vlerës kontabël të llogarisë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”.

Gjithashtu, për këto llogari, në Bashkinë Skrapar mungon një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, periudhat e

shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

- Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtim e konstruksione” në lidhje me kontabilizimin e tyre u konstatua se për një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre ka pasaktësi në pasqyrimin në kontabilitet në lidhje me sipërfaqen, gjendjen e tyre, truallin nën objekt dhe sipërfaqet rrethuese. Një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunat*) dhe janë të pa shoqëruar me kartela objekti. Për çdo objekt të llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” nga Bashkia Skrapar, nuk është bërë verifikimi dhe hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara, saktësimi i objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt.

Sa më sipër llogaria 212 “Ndërtim e konstruksione” dhe llogaria 211 “Pyje Plantacione” nuk paraqesin një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024. Nga titullari i Bashkisë Skrapar, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 “Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë”; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar Kap III, pika 30., (Më hollësisht trajtuar në pikën II, nënpike 2, faqe 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 26-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Skrapar për llogarinë 211 “Pyje Plantacione” dhe llogarinë 212 “Ndërtim e konstruksione”, në lidhje me gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar u konstatua që Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në datën 01.01.2024, është paraqitur në vlerën zero lekë dhe në datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën zero lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Skrapar është aksionarë në Shoqërinë e re të krijuar “Sh. R. U. K. B. Sha” me NIPT M.O, shoqëri e krijuar në bazë të akt marrëveshjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfaqësuar nga AKUM me nr.7183.prot., datë 28.09.2022 dhe Bashkitë Berat, Kuçove, Dimal, Poliçan dhe Skrapar. Bazuar në këtë akt-marrëveshje kapitali fillestar i shoqërisë është 10,000,000 lekë ku Bashkia Skrapar zotëron 4,7% të aksioneve ose në vlerë kapitali 470,000 lekë (10,000,000\*4,7%).

Nga auditimi u konstatua që Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave e Bashkisë Skrapar nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në Shoqërinë e re të krijuar “Sh. R. U. K. B. Sha” me NIPT M.O për vlerën prej 470,000 lekë. Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk paraqet situatën e saktë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për

riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar, me qëllim pasqyrimin e drejtë të vlerës prej 470,000 lekë në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, që i përket pjesëmarrjes në shoqërinë “Sh. R. U. K. B. Sha” me NIPT M..O.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që llogaria 401-408 “Furnitorë e llogarite lidhura me to” në pasqyrat financiare të konsoliduar është paraqitur në vlerën 4,316,066 lekë që përben detyrimet e bashkisë për fatura të mbërritura të pa paguara. Llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm” është paraqitur në vlerën prej zero lekë në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar. Nga auditimi i të dhënave për detyrimet e prapambetura të Bashkisë Skrapar (Qendër) u konstatua që me shkresën nr.480.prot., datë 10.02.2025 për dërgimin e Raportit të Vetëvlerësimit Financiar për vitin 2024 dhe paraqitjen pranë Ministrisë së Financave të “Detyrimeve ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësisë Financiare” janë paraqitur detyrime të prapambetura ndaj të tretëve në vlerën 12,137,246 lekë dhe vlera 595,320 lekë për detyrime për kontrata të lidhura nga Ministritë e Linjës. Në total detyrime të prapambetura të paraqitura në Ministrinë e Financave sipas të dhënave të detajuara janë 12,732,566 lekë. Nga tërësia e të dhënave të raportuara në Ministrinë e Financave për llogarinë 4864 “Detyrime ndaj të treteve” u konstatua që në pasqyrat e pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar janë pasqyruar me pak detyrime ndaj të treteve në vlerën 8,416,500 leke (12,732,566 - 4,316,066) ku vlera prej 4,316,066 leke është vlera e pasqyruar në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Nga auditimi u konstatua që llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm” është nënvlerësuar për vlerën prej 8,416,500 lekë (12,732,566 - 4,316,066).

Këto janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 15 Seksioni 3.1, paragrafi 42. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 33-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje me pasqyrimin e llogarisë 467 “Kreditore të ndryshëm” e cila është nënvlerësuar për vlerën prej 8,416,500 lekë.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i u konstatua se llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” në pasqyrën e pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar duhej të paraqitej në vlerën 20,338,947 lekë dhe është paraqitur në vlerën 20,638,947 lekë. Nga auditimi i pozicionit financiar të llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” sipas njërive shpenzuese u konstatua se në pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar (Qendër) është paraqitur vlera prej 13,896,250 lekë, ndërkohe që sipas të dhënave të kësaj

Ilogarie sipas thesarit (SIFQ) kjo llogari rezultoi në vlerën prej 13,596,250 lekë ose pasqyruar më shumë në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën prej 300,000 lekë (13,896,250-13,596,250). Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” është mbivlerësuar për vlerën prej 300,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa “dh” dhe me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 33-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje me pasqyrimin e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” e cila është mbivlerësuar për vlerën prej 300,000 lekë.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Skrapar në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën 36,880,205 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave për 25 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Skrapar. Një pjesë e fondeve që gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Skrapar i përkasin periudhave të mëparshme të trashëguara nga ish komunat dhe në vazhdim, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave është rakorduar me Degën e Thesarit Skrapar në lidhje me vlerën e trajtuar më sipër por nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,571,010 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe me pikën 3.2, Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” e UMFEnr.5, datë 21.02.2022.

Në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 35-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave bazuar në listën analitike të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 36,571,010 lekë, të marrë masa për të njoftuar subjektet përkatëse dhe të ndjekë grafikun e likuidimit të garancive për objektet e marra në dorëzim.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se për vitin 2024 gjendja në fillim e llogarisë 468 “Debitor të, ndryshëm” është në vlerën 102,473,734 lekë dhe është shtuar gjatë vitit me shumën 13,443,224 lekë. Llogaria 468 “Debitor të, ndryshëm” për vlerën e shtuar të debitorëve të vitit 2024 prej 13,443,224 lekë nuk ka në kundërshtim parti të sajë llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”. Në pasiv të pasqyrave financiare të konsoliduar nuk pasqyrohet llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për tu marrë”. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 115,916,958 lekë dhe duhej pasqyruar në vlerën 102,473,734 lekë që është vlera e debitorëve të viteve të mëparshme që rezultojnë para vitit 2024. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është mbivlerësuar për vlerën

13,443,224 lekë (115,916,958-102,473,734) ndërsa llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” është nënvlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë që është shtesa e debitorëve për vitin 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 7 germa c. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën III.2, faqe 36-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje pasqyrimin e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin detyrime” e cila është mbivlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë dhe të saktësojë llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”, e cila është nënvlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë, që është shtesa e debitorëve për vitin 2024.

### *Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre e cila vjen si pasojë e mos administrimit të saktë të llojeve të detyrimeve tatimore sipas llojit të tyre. Konstatohen pasaktësi në pasqyrimin e taksave dhe tarifave vendore nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave pasi ka paraqitur në pasqyrën e performancës financiare shumën 5,670,966 lekë të ardhura nga taksat dhe tarifave vendore dhe të ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përputhen me të dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse të të ardhurave. Vlera prej 5,670,966 lekë nuk është paraqitur si zë më vete në llogarinë “Tatim nga të ardhurat Personale” por është pasqyruar te llogaria 720 “Grand korent i brendshëm”. Nga auditimi u konstatua se arkëtimet Cash të realizuara gjatë vitit nuk përputhen me vlerën 68,608,126 lekë të paraqitur në pasqyrat financiare. Sipas akt-rakordimit me Thesarin, këto arkëtime rezultojnë në vlerën 64,695,922 lekë. Nga kjo shumë, 63,906,929 lekë përbëjnë të ardhura nga taksat dhe tarifave vendore, si dhe nga pjesëmarrja në taksa nacionale, ndërsa 788,993 lekë janë rimbursim shpenzimesh pas performancës për Këndin Sportiv, vlerë e cila është regjistruar në pasqyrat e konsoliduar të performancës financiare si “Grant korrente i huaj”, llogaria 721. Për sa më sipër arkëtime e të hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor janë në vlerën 3,912,204 lekë më pak (68,608,126-64,695,922), nga të cilat 3,123,211 lekë (3,912,204-788,993) më pak fonde të përdorura në funksion të shpenzimeve korente dhe investimeve. Sipas pasqyrës së “Cash flow” total fonde në dispozicion janë 727,457,639 lekë dhe sipas përlllogaritjeve janë në vlerën 724,334,428 lekë (727,457,639-3,123,211).

Nga auditimi i pasqyrimin të të ardhurave në pasqyrën e performancës financiare u konstatua që janë pasqyruar të ardhura në vlerën 558,707,951 lekë dhe duhej të pasqyroheshin 552,377,088 lekë ose janë pasqyruar 6,330,863 lekë më shumë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 4 pika 7; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1 dhe pika 1.3. dhe me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme i ndryshuar pika 2.3. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën III.2, faqe 38-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin saktë të akordimeve buxhetore korente dhe kapitale në pasqyrën “Cash

flow” për vlerën 3,123,211 lekë si dhe të marrë masa që në pasqyrën performancës financiare të pasqyroje saktë të ardhurat dhe vlerën e drejtë të tyre për vlerën e mbi vlerësuar prej 6,330,863 lekë.

***Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare në pasqyrat financiare të konsoliduar u konstatua që llogaria 73 “*Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve*” në datën 31.12.2024 është pasqyruar në vlerën minus 2,134,106 lekë, vlerë e cila është pasqyruar gabim në pasqyrat financiare të konsoliduar, pasi vlera e kësaj llogarie duhet të ishte paraqitur zero lekë rrjedhimisht është nënvlerësuar për vlerën 2,134,106 lekë. Vlera prej minus 2,134,106 lekë është paraqitur edhe në llogarinë 63 “*Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit*”, për rrjedhojë është dhënë efekt i përsëritur në llogaritjen e rezultatit të veprimtarisë ekonomike. Ky veprim ka sjellë uljen e rezultatit të veprimtarisë së vitit ushtrimor në vlerën 2,134,106 lekë. Për rrjedhojë rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor duhet të pasqyrohej në pasqyrën e performancës financiare (Formati nr.2) llogaria 85 “*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*” në vlerën **62,110,366 lekë** (558,707,951+2,134,106-498,731,691).

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, Kreu II. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 42-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin në pasqyrën e performancës financiare të llogarisë 73 “*Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve*” për pasqyrimin e saktë dhe të drejtë të sajë për vlerën e nënvlerësuar prej 2,134,106 lekë, në mënyrë që të saktësohet edhe vlera e llogarisë 85 “*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*”.

***Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025***

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua se për mbajtjen e kontabilitetit nuk veprohet në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara por në bazë të likuidimit të shpenzimeve rrjedhimisht shpenzimet nuk janë paraqitur në mënyrë të saktë dhe të drejtë për vitin 2024.

- Llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*” është pasqyruar në vlerën 248,713,868 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 251,275,721 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 2,561,853 lekë.

- Llogaria 435-436 “*Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore*” është pasqyruar 41,672,619 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 42,732,827 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 1,060,208 lekë.

- Llogaria 602 “*Blerje mallra dhe shërbime*” është pasqyruar 78,785,490 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 81,477,989 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 2,692,499 lekë.

Nga tërësia e të dhënave të mësipërme janë pasqyruar më pak në pasqyrat e performancës financiare shpenzime për shumën 6,314,560 leke (2,561,853+1,060,208+2,692,499).

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 3, Kapitullin II, ndryshimet në Rubrikën 2.3, paragrafi 8 dhe 9.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 45-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin në pasqyrën e performancës financiare të shpenzimeve për vlerën e nënvlerësuar prej 6,314,560 lekë, si dhe të marrë masa për njohjen e shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare të pasqyrave të konsoliduar u konstatua që llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” është pasqyruar në pasqyrat e konsoliduar në vlerën 393,908 lekë, ndërkohë që sipas thesarit është në vlerën 128,650,258 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare në vlerën 128,256,350 lekë.

Nga auditimi konstatohet që është pasqyruar në pasqyrat e performancës financiare llogaria 604 “Transferime korente të brendshme” është pasqyruar më shumë për vlerën 128,650,258 lekë dhe llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” më pak për vlerën 128,650,258 lekë. Llogaria 604 “Transferime korente te brendshme” duhej të pasqyrohej në vlerën 2,882,652 lekë ndërsa llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjar e Individë” duhej të pasqyrohej në vlerën 128,650,258 lekë. Ndryshimet janë si pasoje i keq klasifikimit të llogarive me njëra tjetrën.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 3.1, nënpika 28, 29.

*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 48-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masat për të siguruar kontabilizimin e saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare, me qëllim dhënien informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve të kryera me arkë për periudhën e përzgjedhur rezultoi se, furnizimin me dokumente të përdorura për arkëtime dhe pagesa (mandat arkëtime dhe mandat pagesa), sipas hyrjes me nr. 46, datë 20.12.2024, Bashkia Skrapar e ka bërë nga persona të rastësishëm dhe jo nga shtypshkronja e letrave me vlerë. Mandat arkëtimet e përdorura nuk kanë numër serie të para shtypur. Përdorimi i këtyre dokumenteve që nuk përmbushin standartet ligjore për përdorim në sektorin publik ka risk të lartë që ka të bëjë me ruajtjen e gjurmës së auditimit.

Dokumentet e përdorura për arkëtimet (mandat arkëtime) janë pa numër serial dhe në disa raste të firmosura nga arkëtari dhe personi që ka bërë arkëtimin.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 68.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6/ç, 12/dh dhe Vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2.

*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 50-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa që furnizimi i dokumentacionit të përdorur për veprimet me arkë të bëhet nga subjekte të autorizuar siç është shtypshkronja e letrave me vlerë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” u konstatua që në këtë llogari nuk janë pasqyruar debitorët nga kontrata e qirasë të fondit pyjor kullosorë. Subjektet që nuk kanë likuiduar detyrimet për vitin 2024 janë në vlerën 2,837,420 lekë dhe konkretisht subjekti “*O.*” në vlerën 35,000 lekë subjekti “*HPP V.E.*” në vlerën prej 138,245 lekë dhe subjekti “*M. E.*” në vlerën prej 2,664,175 lekë. Debitorët në vlerën 2,837,420 lekë (35,000 +138,245 +2,664,175) nuk janë përfshirë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në rakordimin e bërë me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave për debitorët. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet drejtorive përkatëse dhe marrëdhënia shpresore midis strukturave të bashkisë që ka të bëjë me rakordimet në lidhje me debitorët është bërë me shkresa të pa protokolluara në zyrën e protokoll arshivës.

Kontabilizimi jo i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Si pasojë e mos kontabilizimit të debitorëve dhe mos paraqitjes së saktë të tyre në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në fund të vitit 2024, vlera 2,837,420 lekë përben të ardhura të munguara.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “*Për arkivat*”, nenet 11-20 të “*Norma tekniko-profesionale*” dhe neni 22, si dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

(*Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 20-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masat për kontabilizimin në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” të debitorëve të pa regjistruar që rrjedhin nga kontratat e qirasë së fondit pyjor-kullosor, në vlerën totale 2,837,420 lekë, përkatësisht: subjekti “*O.*”, në vlerën 35,000 lekë, subjekti “*HPP V. E.*” në vlerën prej 138,245 lekë dhe subjekti “*M. E.*” në vlerën prej 2,664,175 lekë.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve të Bashkisë Skrapar në nën llogarinë 627400, u konstatua që përgjatë vitit 2024 bashkia ka kryer likuidime në vlerën 2,695,558 lekë për shpenzime gjyqësore dhe shpenzime përmbarimore në 8 (tetë) urdhër shpenzime të cilat janë shpenzime pa ekonomikitet 3E të buxhetit të bashkisë në vlerën 2,695,558 lekë.

Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhet.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr.

9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.  
(Më hollësisht trajtuar në nënplikën III.2, faqe 47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të Buxhetit të Bashkisë në vlerën 2,695,558 lekë, shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore mbi pagesat e kryera për vendimet gjyqësore për gjyqet e fituara.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **D. MASA DISIPLINORE**

**D1.** Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Skrapar të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

“Vërejtje” për 2 (dy) punonjësit, si më poshtë:

**1. Z. E. O.,** me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

**2. Znj. I. O.,** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, i dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, i ndryshuar, pika 114.

#### **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Skrapar, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

### **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**